

## RAPORTE 3-MUJORE, 6-MUJORE, VJETORE

(Sipas Kërkesave të Rregullores Nr. 60, datë 29.08.2008 të Bankës së Shqipërisë për “KERKESAT MINIMALE TE PUBLIKIMIT TE INFORMACIONIT NGA BANKAT DHE DEGET E BANKAVE TE HUAJA” )

Për periudhën e mbyllur në Shtator

### PËRMBAJTJA:

1. Informacion mbi aktivitetin kryesor, organizimin, drejtimin dhe kontrollin e Bankës.....	3
1.1 Informacion i përgjithshëm.....	3
1.2 Informacion i përgjithshëm mbi degët e bankave të huaja.....	3
1.3 Struktura Organizative.....	3
1.3.1 Këshilli Drejtues.....	4
1.3.2 Kualifikimet dhe përvoja e anëtarëve të Këshillit Drejtues.....	4
1.3.3 Komiteti i Kontrollit.....	7
1.3.4 Kualifikimet dhe përvoja e anëtarëve të Komitetit të Kontrollit.....	7
1.3.5 Struktura Aksionere.....	8
1.3.6 Informacion mbi strukturën e Grupit të konsoliduar, pjesë e të cilit është Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a.....	9
1.4 Informacion mbi aktivitetet e bankës.....	10
1.5 Informacion mbi filialet e bankave dhe sipërmarrjet ku bankat janë aksionere.....	10
1.6 Informacion mbi sipërmarrjet mëmë dhe sipërmarrjet aksionere kryesore në banka .....	10
1.7 Informacion i degës së bankës së huaj lidhur me bankën-mëmë .....	10
2. Bilanci kontabël, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe treguesit e rentabilitetit.....	11
2.1 Bilanci kontabël.....	11
2.2 Pasqyra e të ardhurave.....	13
2.3 Treguesit e rentabilitetit.....	14
2.4 Zërat jashtë bilancit.....	15
3. Struktura e kapitalit regullator.....	16
4. Mjaftueshmëria e kapitalit .....	17
4.1 Rreziku i kredisë .....	17

4.2 Rreziku operacional.....	17
4.3 Totali i zërave të bilancit dhe jashtë bilancit të ndara sipas klasave të ekspozimit.....	18
5. Informacion i përgjithshëm cilësor për ekspozimin ndaj rreziqeve.....	19
5.1 Kuadri i Administrimit të Rrezikut .....	19
6. Rreziku i kredisë: Informacion i përgjithshëm.....	20
6.1 Rreziku i kredisë.....	20
6.2 Rreziku i shlyerjes.....	24
7. Rreziku i kredisë: Informacion për portofolin e kredisë sipas metodës standard.....	24
8. Teknikat e zbutjes së rrezikut.....	24
9. Rreziku i kredisë së kundërpalës.....	26
10. Titullzimi.....	27
11. Rreziqet e tregut: Informacion i përgjithshëm.....	27
12. Rreziku operacional.....	27
13. Ekspozimet në instrumente të kapitalit: informacion mbi pozicionet e përfshira në librin e bankës.....	27
14. Rreziku i normës së interesit në librin e bankës.....	27
15. Rreziku i likuiditetit.....	28
15.1 Rreziku i likuiditetit.....	28
15.2 Administrimi i rrezikut të likuiditetit.....	28
16. Depozita ekuivalente e kapitalit të degës së bankës së huaj.....	29
17. Matja dhe kontrolli i kufijve të rrezikut të degës së bankës së huaj.....	29
18. Politikat e shpërblimit.....	30
19. Format dhe elementët e shpërblimit për Këshillin Drejtues dhe drejtuesit ekzekutivë.....	30
20. Politikat kontabël.....	31


**1. Informacion mbi aktivitetin kryesor, organizimin, drejtimin dhe kontrollin e Bankës**

**1.1 Informacion i përgjithshëm**

Emri tregtar: Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a  
 Forma juridike: Shoqëri Aksionere  
 Adresa: Rr. "Ismail Qemali" Nr.27, Tiranë  
 Numri serial i certifikatës së regjistrimit në QKR: 1091410005  
 Data e regjistrimit: 17/06/1998  
 NIPT (NUIS): J81817006P  
 Kapitali sipas QKR: LEK 5.562.517.674,00  
 Kapitali aksionar më 31 Mars  
 Numri i aksioneve : 15,581,282  
 Vlera nominale: LEK 357  
 Totali i vlerës së aksioneve: LEK 5,562,517,674

**1.2 Informacion i përgjithshëm mbi degët e bankave te huaja Jo e aplikueshme (N/A)**

**1.3 Struktura Organizative në 31 Mars 2023**



Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. operon në të gjithë Shqipërinë nëpërmjet **35 degëve** nëpërmjet një numër total të stafit prej **719 vetësh** në **31 Mars 2023**.

### *1.3.1 Këshilli Drejtues*

**Z. Božo Prka** - Kryetar i Këshillit Drejtues

**Z. Paolo Genovese** - Zv. Kryetar i Këshillit Drejtues

**Z. Mauro Rossi**- Anëtar - Drejtor i Departamentit të Planifikimit dhe Kontrollit Financiar, Divizioni Ndërkombëtar i Bankave Filiale, Intesa Sanpaolo

**Z. Gabriele Gherardi** – Anëtar – Drejtues i Nën-Departamentit të Menaxhimit & Zhvillimit të Njerëzve, DNBF, Milano

**Z. Alessandro D’oria** - Anëtar - Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv, Intesa Sanpaolo Bank Albania

**Znj. Amina Carnabuci** – Anëtare – Drejtore e Konsulencës Financiare në Divizionin Ndërkombëtar të Bankave Filiale

**Z. Konrad Kozik** - Anëtar

### *1.3.2 Kualifikimet dhe përvoja e anëtarëve të Këshillit Drejtues*



#### **Božo Prka (Kryetar i Bordit Drejtues)**

Në Korrik të 2018 u emërua Kryetar i Bordit të Drejtorëve i Intesa Sanpaolo Bank Albania sha.

Që nga Shkurti i 1998 deri në Shkurt 2018, Z. Prka ka qenë emëruar President i Bordit Drejtues i Privredna Banka Zagreb.

Në të kaluarën ka shërbyer në Ministrinë e Financave të Republikës së Kroacisë (nga viti 1992 deri në vitin 1997) dhe ka mbajtur postin e Ministrit të Financave të Kroacisë për tre vjet (nga viti 1994 deri në vitin 1997), dhe më parë ai ishte zëvendës Ministër i Financave.

Z. Prka ka qenë gjithashtu Anëtar i Këshillit Kombëtar të Konkurrencës Kroate që nga themelimi i tij në 2002.

Gjatë mandatit të tij si Ministër i Financave, Z Prka mori në vitin 1996 Çmimin e “Ministrit të Vitit” nga Central European Magazine (Revista e Europës Qendrore).

Në cilësinë e tij si Kryetar i Bordit Drejtues të PBZ-së, në vitin 2003, Z. Prka mori Çmimin “Bankieri i Vitit” i Europës Jug-Lindore, dhënë nga revista Finance Central Europe, dhe mori përsëri të njëjtin çmim

nga Finance Central Europe si "Bankieri i Vitit" në Kroaci, për vitin 2006.

Z. Bozo Prka u diplomua në vitin 1982 në Ekonomi & Tregti e Jashtme nga Universiteti i Zagrebit dhe në vitin 1996 ai mori diplomën e Masterit Shkencor në Ekonomi, përsëri në Universitetin e Zagrebit.



**Paolo Genovese (Zëvendës Kryetar)**

Në qershor 2014 ai u emërua anëtar i Këshillit Drejtues të Intesa Sanpaolo Bank Albania. Përvoja e punës së Z. Genovese i është dedikuar kryesisht Sektorit të Rrezikut të Kredisë në Itali dhe me Intesa-n jashtë vendit të tij. Në të njëjtën kohë ai ka një përvojë të madhe në këtë fushë edhe me bankat e tjera në Itali.

Nga Prilli 2007 deri në Dhjetor 2009, ai ka qenë Drejtori i Përgjithshëm i Riskut për KMB Bank në Moskë (Grupi ISP). Një pozicion tjetër që ka mbajtur në Bankën Intesa

është Drejtori i Riskut për zonën/rajonin e Trevizos gjatë periudhës 2004-2009.

Ai ka punuar në Drejtorinë Qendrore në Milano gjatë viteve 1996 - 2004 për herë të parë si anëtar i Zyrës Qendrore të Njesisë së Kredisë, dhe më pas Përgjegjës për Analizën dhe Monitorimin e e Kredisë së Rrjetit të Degëve në Itali. Ai ka qenë Drejtor i Sekretariatit të Kredisë në Degën e Londrës me Banco Ambrosio Veneto gjatë periudhës 1992-1996.

Nga Korriku 1989 deri në Dhjetor 1991, ai ka mbajtur pozicionin e Drejtorit të Departamentit të Kredisë në Bankën Vallone - Galatina (LE), e cila kontrollohej nga Banco Ambrosio Veneto.



Ndërsa në Bankën Cattolica del Veneto ai ka mbajtur pozicionet në vijim: Analist kredie, Zëvendës Drejtor Dege i Belluno dhe S.Maria del Rovere (Trevizo), Drejtor i Zyrës së Sekretariatit të Kredisë për zonën e Veronës dhe Trevizos. Ai e filloi karrierën e tij në Maj 1977 si punonjës dege në Bankën Cattolica del Veneto, Filiale i Gaiarine. Z. Paolo Genovese ka një Diplomë Universitare në "Ekonomi dhe Tregti" nga Universiteti Ca'Foscari – Venezia.

**Z. Mauro Rossi (Anëtar)**

Në Tetor 2020 është bërë anëtar i Bordit Drejtues të Intesa Sanpaolo Bank Albania. Z. Rossi është aktualisht në pension dhe deri ne Prill te 2018 ka mbajtur pozicionin e Drejtorit të Departamentit të Investimeve të Kapitalit, Intesa Sanpaolo Torino. Z.

Rossi është diplomuar në Shkenca Politike në Università degli Studi di Torino, Torino, (1985) me vlerësimin 110/110 me nderime, dhe ka ndjekur një Master në Administrim Biznesi, në Shkollën e Administrimit të Shoqërive, Torino (vlerësimi 110/110). Z. Rossi nisi karrierën e tij në sektorin bankar në 1977 pranë Istituto Bancario Sanpaolo di Torino duke mbuluar detyra të ndryshme si Analist në Departamentin e Investimeve të Kapitalit. Ne vitin 1998 u emërua Drejtor ne fushën e Investimeve të Kapitalit dhe ka mbajtur këtë detyrë deri ne Prill të 2018. Z. Rossi është githashtu anëtar i Këshillit Drejtues të: Intesa Sanpaolo Innovation Center S.p.A., Torino, (Tetor, 2018 – vazhdim) si edhe i Euromilano S.p.A., Milano, (Shtator 2019 – vazhdim).



**Z. Gabriele Gherardi (Anëtar)**

Në Maj 2017 është bërë anëtar i Bordit Drejtues të Intesa Sanpaolo Bank Albania. Z. Gherardi aktualisht mban pozicionin e Drejtuesit të Nën-Departamentit të Menaxhimit & Zhvillimit të Njerëzve, DNBFI, Milano. Pas diplomimit në Jurisprudencë në Universitetin e Pizës (1982) me mesatare 110/110 me nderime, Z. Gherardi nisi karrierën e tij në sektorin bankar në 1985 pranë Banca Commerciale Italiana S.p.a.

Eksperiencën e punës e Z. Gherardi, dedikuar tërësisht sektorit të Burimeve Njerëzore, përfshin një shkallë të gjerë të pozicioneve menaxheriale si:

- Drejtues i Burimeve (Përgjegjës për BNJ, Organizimin dhe fushën e Shërbimeve të Përgjithshme) në Mediocredito Italiano 2014 - 2015
- Drejtues i Burimeve, Leasint 2011 – 2013
- Drejtues i Menaxhimit të Njerëzve në Divizionin e Korporatave dhe Investimeve Bankare 2001- 2011
- Me parë në Banca Commerciale Italiana S.p.a. ai ka mbajtur pozicione si:
- Koordinator i BNJ për Rrjetin Ndërkombëtar (Filialet, Degët & Zyrtat e Përfaqësuesve) dhe për “Wholesale Banking”,
- Drejtues i Zonës së Trajnimit, Menaxher i BNJ përgjegjës për punonjësit me potencial të lartë.
- Nga Marsi 2013 në Dhjetor 2013, ishte anëtar i Bordit Drejtues të Centro Leasing S.p.a.



**Alessandro D'oria (Anëtar)**

Alessandro D'oria është Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Intesa Sanpaolo Bank Albania. Alessandro D'oria vjen nga një përvojë e gjatë dhe e suksesshme në sektorin bankar. Ai ka qenë pjesë e Bankës Intesa, para bashkimit të saj me Sanpaolo IMI për të krijuar grupin Intesa Sanpaolo. Gjatë viteve 1987-1996, z. Alessandro D'Oria mbante postet e Menaxherit të Marrëdhënieve me Klientin dhe Menaxherit të Degës në rajonin e Pulias, ndërsa nga 1997 deri në 2010 ai ka mbajtur përgjegjësinë e Menaxherit të Segmentit të Individëve në disa rajone italiane për grupin Intesa Sanpaolo. Gjatë periudhës 2011-2014, z. Alessandro D'Oria u emërua Drejtor i zonës së Pulias në Divizionin “Banca dei Territori” të Intesa Sanpaolo. Ndërkohë, në të njëjtën kohë ai mbante postet e Kryetarit të Komisionit Rajonal të Shoqatës së Bankave Italiane (SHBI) për Pulian dhe ishte Anëtar i Dhomës së Tregtisë të Pulias për sektorët e Kredisë dhe Sigurimeve. Gjatë periudhës 2015-2016, ai u emërua, gjithmonë brenda Divizionit të “Banca dei Territori”, si Drejtor i Rajonit të Milanos dhe Provincave rreth - një nga shtatë rajonet e Rrjetit të Bankës Intesa Sanpaolo në Itali - dhe Nënkyetar i Komisionit Rajonal të Shoqatës Italiane të Bankave (SHIA) për Lombardinë.

Më tej, brenda Divizionit Ndërkombëtar të Bankave Filiale të grupit Intesa Sanpaolo, z. Alessandro D'Oria qëndroi në pozicionin e Drejtuesit të Nën-Departamentit të Shitjes për Individë nga 2017 në 2019

ndërsa në fillim të vitit 2020, ai u emërua si Drejtues i Departamentit të Individëve dhe të Menaxhimit të Klientëve me të ardhura të larta. Z. Alessandro D’Oria aktualisht mban pozicionin e Anëtarit të Bordit Jo-Ekzekutiv, Kryetarit të Komitetit të Riskut dhe Komitetit të Auditimit të anëtarëve në Bankën e Aleksandrisë, filial i grupit Intesa Sanpaolo në Egjipt.

### **Znj. Amina Carnabuci (Anëtare)**

Anëtare e Bordit të Drejtorëve të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. që nga 19 janari 2021, sipas miratimit nga Banka e Shqipërisë.

Znj. Amina Carnabuci ka një përvojë shumëvjeçare në Industrinë Bankare në Itali, kryesisht në pozitat e Financave, Thesarit, Planifikimit, Kontrollit dhe Drejtuesve të Lartë.

Ajo filloi karrierën e saj si analiste softuerësh për sistemet e Financave dhe të Shkëmbimit Forex, me La Centrale servizi, viti 1987. Nga Gushti 1988 deri në Korrik 1994, ajo vazhdoi si Menaxhere e Projektit të sistemit Bankar Itali, Shefe e Njesisë së Tregjeve të Kapitalit me Concept Italia & Diagram Italia.

Me Caboto Holding S.p.A. (tani Banca IMI) Znj. Carnabuci mbuloi pozicione të ndryshme në Zonën e Riskut nga korriku 1995 deri në gusht 2000. Përvoja e saj me këtë kompani vazhdoi me Zyrтарin e Lartë Ekzekutiv Caboto Secuits deri në shtator 2003.

Znj. Carnabuci ndoqi karrierën e saj bankare me Intesa Sanpaolo S.p.A. nga tetori 2003 deri më tani, duke mbuluar pozicione të ndryshme në strukturat: Departamenti i Planifikimit dhe Kontrollit, Zyra e Kontrollit të Financave dhe Thesarit.

Nga Dhjetori 2004 deri në Janar 2007, Znj. Carnabuci mbuloi pozicionin e Drejtueses së Zyrës së Thesarit dhe Kontrollit brenda Departamentit të Planifikimit dhe Kontrollit, dhe më pas mori një pozicion të ri si Shefe e Nën-Departamentit të Financave dhe Tregut të Kapitalit brenda Departamentit të Kontrollit deri në Nëntor 2009. Nga nëntori 2009 deri në prill 2018 znj. Carnabuci mbajti postin e Shefit të Nën-departamentit të Koordinimit dhe Kontrollit të Thesarit në Departamentin e CFO dhe Thesarit.

Nga maji i vitit 2018 e deri më sot Znj. Carnabuci mban pozicionin e Shefes së Këshilltarit Financiar brenda ISBD-së.

Znj. Carnabuci ka marr diplomën Diplome d’Etudes Politiques (IEP) në seksionin Economique et Financiare Institut d’etudes Politiques Grenoble, viti 1983. Ndjekur nga një Diplomë në Shkencat Ekonomike në Universitetin Grenoble II, viti 1984; në vitin 1985 ajo kishte një DEA në Financat Ndërkombëtare në Univeristë Paris-Dauphine.

Ajo është anëtare e bordit ekzekutiv në Intesa Sanpaolo d.d. Sllovenia.

### **Z. Konrad Kozik (Anëtar)**

Anëtar i Bordit të Drejtorëve të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. që prej 9 Mars 2021, sipas miratimit nga Banka e Shqipërisë.



Z. Konrad Kozik ka një përvojë shumëvjeçare në Industrinë Bankare në Itali në pozicione të Larta Menaxheriale dhe jashtë kufijve, dhe një përvojë shumë të gjerë me Kompanitë e Sigurimeve, përgjegjëse për fushat që mbulojnë Departamentin e Kontabilitetit, Departamentin e Planifikimit Strategjik dhe Kontrollit, Drejtorin e Përgjithshëm të Riskut dhe Departamenti i Riskut, Drejtori i Aksionarit P&C dhe Departamenti i Aktuarit të Pasurisë dhe Fatkeqësisë, Departamenti i Aktuarit të Jetës dhe Jetës i Kryesor të Aktuarit, Departamenti i Administratës Tatimore dhe Këshillimit, Departamenti i Prokurimit, Departamenti i Thesarit.

Ai filloi karrierën e tij të punës me Roland Berger & Partners S.p.A. si Konsulent 1994-1996.



Përvoja e tij e punës vazhdoi me Pricewaterhouse Coopers Management Consulting Services S.p.A Itali, si Drejtor i Përgjithshëm i Lartë nga Shtatori 1996 për një periudhë 2 vjeçare.

Nga Shtatori 1998 dhe një periudhë 1-vjeçare Z. Kozik u bashkua me Booz Allen & Hamilton S.p.A. (Milano, Itali) Shërbimet Këshilluese Strategjike, si bashkëpunëtor i Lartë.

Z. Kozik pranoi një pozicion të ri brenda UniCredit Group S.p.A. si Zëvendës President i Parë përgjegjës për integrimin pas-blerjes të Bank Pekao S.A. në strukturat e grupit, nga gushti 1999 deri në dhjetor 2001.

Më pas ai mori një pozicion të ri si Zyrtar Kryesor Financiar i punësuar në UniCredit Bank S.A në Bukuresh, Rumani deri në maj 2004.

Më pas Z. Kozik u punësua në KBC Group N.V, Kredyt Bank S.A Varshavë, Poloni deri në Prill 2007, në pozicionin e Zëvendës Kryeshefit Ekzekutiv, Zyrtarit Kryesor Financiar.

Brenda Grupit UniCredit Z. Kozik vazhdoi si Zëvendës President i Lartë dhe anëtar i Bordit Drejtues në UniCredit Bank Moskë, Rusi deri në Shtator 2014.

Me Kompaninë e Sigurimeve Allianz J dhe Kompania e Sigurimeve Allianz Life LLC Moskë, Rusi dhe më pas në Varshavë të Polonisë, Z. Kozik mbajti postin e Zëvendës Kryeshefit Ekzekutiv dhe Zyrtarit Kryesor Financiar deri në Dhjetor 2018.

Nga Janari 2019 deri më sot Z. Kozik është Këshilltar i Pavarur duke ofruar shërbime për institucionet financiare.

Në të njëjtën kohë, ai është Drejtor Jo-Ekzekutiv Anëtar i Bordit Mbikëqyrës, Moldavi, që nga korriku i vitit 2020.

Arsimi i Z. Kozik përfshin një Diplomë të Shkollës së Mesme Katolike të Verilindjes, Filadelfia, SHBA; Ndjekur nga Diplomë Bachelor në Ekonomi dhe Administrim Biznesi, Universidad de Navarra, Pamplona, Spanjë; dhe një Diplomë Master në Ekonominë dhe Menaxhimin Ndërkombëtar, SDA Bocconi, Milano, Itali.

### **1.3.3 Komiteti i Kontrollit**

<b>Konrad Kozik</b>	Kryetar i Komitetit të Kontrollit Bozo Prka Anëtar Zoltan Mogyorosi Anëtar
<b>Bozo Prka</b>	Anëtar
<b>Zoltan Mogyorosi</b>	Anëtar

### **1.3.4 Kualifikimet dhe përvoja e anëtarëve të Komitetit të Kontrollit**

#### **Z. Konrad Kozik (Anëtar)**



Anëtar i Bordit të Drejtorëve të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. që prej 9 Mars 2021, sipas miratimit nga Banka e Shqipërisë.

Z. Konrad Kozik ka një përvojë shumëvjeçare në Industrinë Bankare në Itali në pozicione të Larta Menaxheriale dhe jashtë kufijve, dhe një përvojë shumë të gjerë me Kompanitë e Sigurimeve, përgjegjëse për fushat që mbulojnë Departamentin e Kontabilitetit, Departamentin e Planifikimit Strategjik dhe Kontrollit, Drejtorin e Përgjithshëm të Riskut dhe Departamenti i Riskut, Drejtori i Aksionarit P&C dhe Departamenti i



Aktuarit të Pasurisë dhe Fatkeqësisë, Departamenti i Aktuarit të Jetës dhe Jetës i Kryesor të Aktuarit, Departamenti i Administratës Tatimore dhe Këshillimit, Departamenti i Prokurimit, Departamenti i Thesarit.

Ai filloi karrierën e tij të punës me Roland Berger & Partners S.p.A. si Konsulent 1994-1996.

Përvoja e tij e punës vazhdoi me Pricewaterhouse Coopers Management Consulting Services S.p.A Itali, si Drejtor i Përgjithshëm i Lartë nga Shtatori 1996 për një periudhë 2 vjeçare.

Nga Shtatori 1998 dhe një periudhë 1-vjeçare Z. Kozik u bashkua me Booz Allen & Hamilton S.p.A. (Milano, Itali) Shërbimet Këshilluese Strategjike, si bashkëpunëtor i Lartë.

Z. Kozik pranoi një pozicion të ri brenda UniCredit Group S.p.A. si Zëvendës President i Parë përgjegjës për integrimin pas-blerjes të Bank Pekao S.A. në strukturat e grupit, nga gushti 1999 deri në dhjetor 2001.

Më pas ai mori një pozicion të ri si Zyrtar Kryesor Financiar i punësuar në UniCredit Bank S.A në Bukuresh, Rumani deri në maj 2004.

Më pas Z. Kozik u punësua në KBC Group N.V, Kredyt Bank S.A Varshavë, Poloni deri në Prill 2007, në pozicionin e Zëvendës Kryeshefit Ekzekutiv, Zyrtarit Kryesor Financiar.

Brenda Grupit UniCredit Z. Kozik vazhdoi si Zëvendës President i Lartë dhe anëtar i Bordit Drejtues në UniCredit Bank Moskë, Rusi deri në Shtator 2014.

Me Kompaninë e Sigurimeve Allianz J dhe Kompania e Sigurimeve Allianz Life LLC Moskë, Rusi dhe më pas në Varshavë të Polonisë, Z. Kozik mbajti postin e Zëvendës Kryeshefit Ekzekutiv dhe Zyrtarit Kryesor Financiar deri në Dhjetor 2018.



#### **Bozo Prka – Anëtar**

Që nga Shkurti i 1998 deri në Shkurt 2018, Z. Prka ka qenë emëruar President i Bordit Drejtues i Privredna Banka Zagreb.

Në të kaluarën ka shërbyer në Ministrinë e Financave të Republikës së Kroacisë (nga viti 1992 deri në vitin 1997) dhe ka mbajtur postin e Ministrit të Financave të Kroacisë për tre vjet (nga viti 1994 deri në vitin 1997), dhe më parë ai ishte zëvendës Ministër i Financave.

Z. Prka ka qenë gjithashtu Anëtar i Këshillit Kombëtar të Konkurrencës Kroate që nga themelimi i tij në 2002. Gjatë mandatit të tij si Ministër i Financave, Z Prka mori në vitin 1996 Çmimin e “Ministrit të Vitit” nga Central European Magazine (Revista e Europës Qendrore).

Në cilësinë e tij si Kryetar i Bordit Drejtues të PBZ-së, në vitin 2003, Z. Prka mori Çmimin “Bankieri i Vitit” i Europës Jug-Lindore, dhënë nga revista Finance Central Europe, dhe mori përsëri të njëjtin çmim nga Finance Central Europe si “Bankieri i Vitit” në Kroaci, për vitin 2006.

Z. Bozo Prka u diplomua në vitin 1982 në Ekonomi & Tregti e Jashtme nga Universiteti i Zagrebit dhe në vitin 1996 ai mori diplomën e Masterit Shkencor në Ekonomi, përsëri në Universitetin e Zagrebit.



#### **Zoltan Mogyorosi– Anëtar**

Aktualisht mban pozicionin e Shefit të Auditimit të Bankave të Huaja të Intesa Sanpaolo. Karriera e tij në Auditimin e Brendshëm filloi në 2005 me CIB Bank Hungary (një degë e Intesa Sanpaolo) si Zëvendës Drejtues i Auditimit të Brendshëm dhe vazhdoi nga viti 2006 deri në 2011 si Drejtues i Departamentit të Auditimit të Brendshëm. Nga korriku 2011, z. Mogyorosi filloi kompaninë e tij ndërkombëtare transportuese Intesa Sanpaolo në Milano, si Specialist i Lartë deri në qershor 2016. Në korrik 2016 z. Mogyorosi u emërua Drejtues i Auditimit të

Bankave të Huaja të Intesa Sanpaolo, rol të cili aktualisht mbulon. Përvoja e mëparshme e punës së z. Mogyorosi përfshinte: me CIB Bank Hungary si Drejtues i Shërbimeve të Kujdestarisë dhe pozicione të tjera të ndryshme në CIB Hungari në Administrimin e Kredive, Auditimin e Brendshëm etj. Në pozicionin aktual si Drejtues i Auditimit të Bankave të Huaja të Intesa Sanpaolo, z. Mogyorosi po menaxhon aktivitetet e auditimit në vend dhe jashtë saj në bankat filiale të huaja të Grupit Intesa Sanpaolo. Ai po koordinon ndër-aktivitetet / rishikimet tematike me përfshirjen e ekipeve të ndryshme të auditimit në nivel Grupi. Ai po kontribuon në përmirësimin e cilësisë së metodologjive dhe aktiviteteve të auditimit të funksioneve vendase të AB të bankave të huaja filialë. Në përvojën e tij të mëparshme si Specialist i Lartë Auditues i bankave të huaja, ai kishte mundësinë të monitoronte bankat e huaja degë të Intesa Sanpaolo (rajonet EQL, CIS dhe SM) dhe të kryente aktivitete auditimi në terren. Ai ka marrë pjesë në zhvillimin e metodologjisë, duke e sjellë metodologjinë e auditimit në grup në përputhje me ndryshimin e kërkesave rregullatore evropiane. Anëtarësimi i tij në Komitetet e Auditimit në filialet e tjera të Intesa Sanpaolo përfshijnë: anëtar i Komitetit të Auditimit të ISP BIH - ISP Group nga 01/2017 deri më 05/2020; anëtar i Komitetit të Auditimit të Veneto Banka sh.a nga data 04.2018 deri më 10.2018. Dhe aktualisht anëtar i Komitetit të Auditimit të ISPAL që prej datës 26 maj 2021.

### 1.3.5 Struktura Aksionere

Subjekti: Intesa Sanpaolo S.p.A. Piazza san Carlo, 156 10121 Torino, Italy  
 % Pjesëmarrja në Bankë: 100%

### 1.3.6 Informacion mbi strukturën e Grupit të konsoliduar, pjesë e të cilit është Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a.

Kapitali Social i nënshkruar dhe paguar është 10,084,445,147.92 Euro.


Kapitali Social ndahet në 19,430,463,305 aksione të zakonshme pa vlerë nominale.

Struktura aksionare, e Intesa Sanpaolo është e përbërë si më poshtë vijon (aksioner me mbi 3%):

AKSIONERI	AKSIONE TE ZAKONSHME	% E PRONESISE
<b>Shoqëria San Paolo</b>	1,188,947,304	6.261%
<b>Fondazione Cariplo</b>	961,333,900	5.063%

Për informacion të detajuar dhe përditësuar:

[https://www.group.intesasnpaolo.com/scripts/sir0/si09/investor\\_relations/eng\\_azionariato.jsp#/investor\\_relations/eng\\_azionariato.jsp](https://www.group.intesasnpaolo.com/scripts/sir0/si09/investor_relations/eng_azionariato.jsp#/investor_relations/eng_azionariato.jsp)



### Organisation chart of the Divisions



Informacion sipas 31 Marsr 2023

#### 1.4 Informacion mbi aktivitetet e bankës

Lista e aktiviteve të detajuara që zhvillon banka sipas licencës së marrë nga Banka e Shqipërisë detajohet si më poshtë:

1. Të gjitha format e kredihënies, duke përfshirë kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekore
2. Faktoringun dhe financimin e transaksioneve tregtare
3. Qiranë financiare
4. Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave
5. Tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetë organizuar (OTC) ose ndryshe, si më poshtë:
  - i. Instrumente të tregut të parasë (çeqe, dëftesa, certifikata të depozitave, etj.)
  - ii. Këmbim valutor
  - iii. Instrumente të këmbimeve valutore dhe instrumente për vlerësimin e normës së interesit, duke përfshirë këtu produkte të tilla, si marrëveshje swap dhe marrëveshje që përcaktojnë vlerën e interesit në të ardhmen.

- iv. Letra me vlerë të transferueshme
- 6. Shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e listuara në pikat 1 deri 5 si më sipër.
- 7. Ndërmjetësimin për transaksionet monetare të marrjes në kujdestari, shërbimet depozituese dhe të besimit.
- 8. Emetimin dhe administrimin e instrumenteve të pagesës (të tilla si kartat e kreditit dhe të debitit, çeqet e udhëtarit dhe çeqe bankare, kartat e pagesës dhe pagesa me celular) etj., përfshirë emetimin e parasë elektronike.
- 9. Ofrimin e shërbimit të kasave të sigurimit
- 10. Ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve.

**1.5 Informacion mbi filialet e bankave dhe sipërmarrjet ku bankat janë aksionere**

*Jo e aplikueshme (N/A)*

**1.6 Informacion mbi sipërmarrjet mëmë dhe sipërmarrjet aksionere kryesore në banka**

*Jo e aplikueshme (N/A)*

**1.7 Informacion i degës së bankës së huaj lidhur me bankën-mëmë**

*Jo e aplikueshme (N/A)*

**2. Bilanci kontabël, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe treguesit e rentabilitetit**

**2.1 Bilanci kontabël**

**Bilanci (Aktivet)**

Kodi	Aktivet (ne mijë leke)	TOTALI	TOTALI
		Mars 2023	Dhjetor 2022
<b>1</b>	<b>VEPRIMET ME THESARIN DHE TRANSAKSIONET NDERBANKARE</b>	<b>94,391,377</b>	<b>89,195,523</b>
11	Arka dhe Banka qendrore	28,604,668	27,058,188
12	Bono thesari dhe bono te tjera te pranueshme per rifinancim me B.Qendrore	28,621,048	28,778,785
13	Llogari rrjedhese ne bankat, instituc. e kreditit dhe instituc. e tjera financiare	7,256,443	5,381,970
14	Depozita me bankat, institucionet e kreditit dhe institucione te tjera financiare	29,909,218	27,976,579
15	Hua per bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet te tjera financiare		
<b>2</b>	<b>VEPRIMET ME KLIENTET</b>	<b>52,351,056</b>	<b>55,595,555</b>
20	Hua standarte dhe paradhene per klientet	40,154,366	41,300,744
21	Hua dhe paradhene te papaguara ne afat per klientet		
22	Hua dhe paradhene ne ndjekje	957,227	724,767
23	Hua nenstandart	707,617	750,016
238	Fonde rezerve per mbulimin e humbjeve nga huate nenstandart	(147,142)	(164,734)
24	Hua te dyshimta	273,103	110,865
248	Fonde rezerve per mbulimin e humbjeve nga huate e dyshimta	(143,314)	(56,805)
25	Hua te humbura	364,134	374,996
258	Fondet rezerve per mbulimine e humbjeve nga huate e humbura	(361,332)	(374,154)
26	Qeveria Shqiptare & Administrata Publike	50,924	59,701
27	Detyrimet ndaj klienteve per llogarite rrjedhese dhe depozitat	10,495,474	12,870,159
28	Llogari te tjera te klienteve		
<b>3</b>	<b>VEPRIME ME LETRAT ME VLERE</b>	<b>45,418,667</b>	<b>44,462,570</b>
<b>31</b>	<b>Letra me vlere me te ardhura fikse</b>	<b>43,894,514</b>	<b>44,462,570</b>
311	Letra me vlere te tregtueshme	-	-
312	Letra me vlere te vendosjes	32,736,302	31,640,937
313	Letra me vlere te investimit	11,158,212	12,821,633
<b>34</b>	<b>Letra me vlerë të blera dhe të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes</b>	<b>1,524,153</b>	<b>-</b>
<b>4</b>	<b>MJETE DHE DETYRIME TE TJERA</b>	<b>1,156,383</b>	<b>832,911</b>
41	Mjete te tjera	526,301	487,231
412	Mjete inventari	1,218,878	1,228,234
419	Te ardhura te llogaritura dhe shpenzime te shtyra	243,549	207,292
43	Transaksionet si agjent	7,504	12,905
44	Llogari marredheniesh	2,438	3,638
45	Llogari pezull dhe te pozicionit	622,578	332,775
46	Tatim i vleres se shtuar	-	-
<b>5</b>	<b>MJETET E QENDRUESHME DHE BURIMET E PERHERSHME</b>	<b>2,812,153</b>	<b>2,855,973</b>
51	Interesa pjese-marrese	-	-
52	Filiale	-	-
53	Mjete te qendrueshme	2,812,153	2,855,973
531	Mjetet e patrupezuara	2,763,255	2,738,398
5371	Amortizimi i mjeteve te patrupezuara	(2,033,148)	(1,998,760)
	<b>TOTALI</b>	<b>196,132,073</b>	<b>192,946,169</b>

Gjatë tremujorit të parë portofoli i kredisë paraqet një rënie, kryesisht si rezultat i mbylljes së parakohshme të kredive nga klientët korporatë shoqëruar me ulje të përdoimit të linjës së kredisë. Megjithatë ka patur rritje muajin efundit nga kredite e reja korporate.

Portofoli i letrave me vlerë ka pasur rritje në krahasim me tremujorin e kaluar. Kjo ka ardhur nga investime të reja në portofolin e letrave me vlerë si në tituj të Qeverisë shqiptare, ashtu edhe të huaja.

**Bazuar në të dhënat e muajit Mars 2023, më sipër paraqitet e detajuar pasqyra e aktivitet me kodet e përcaktuara sipas “Sistemit të Raportimit të Unifikuar”.**

Zërat kryesore të aktiveve:

1. Veprime me thesarin dhe transaksione ndërbankare
2. Veprime me klientët
3. Veprime me letra me vlerë
4. Mjete të tjera
5. Mjete të qëndrueshme

Zërat e paraqitur më sipër nuk kanë patur lëvizje materiale nga periudhat e mëparshme.

<b>Bilanci (Pasivet)</b>			
Kodi	PASIVET (ne mije leke)	TOTALI	TOTALI
		Mars 2023	Dhjetor 2022
<b>1</b>	<b>VEPRIMET ME THESARIN DHE TRANSAKSIONET NDERBANKARE</b>	<b>320,674</b>	<b>1,017,783</b>
112	Banka qendrore	103,820	-
12	Bono thesari dhe bono te tjera te pranueshme per rfinansim me B.Qendrore	-	-
13	Llogari rrjedhese ne bankat, instituc. e kreditit dhe instituc. e tjera financiare	95,360	107,195
16	Depozita nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	0	788,152
<b>2</b>	<b>VEPRIMET ME KLIENTET</b>	<b>169,695,314</b>	<b>167,115,012</b>
26	Qeveria Shqiptare & Administrata Publike	2,873,630	1,982,230
27	Detyrimet ndaj klienteve per llogarite rrjedhese dhe depozitat	166,517,809	164,826,675
271	Llogarite rrjedhese	87,971,857	86,220,010
272	Llogari depozitash pa afat	29,137,491	30,049,820
273	Llogari depozitash me afat	49,408,461	48,556,845
274	Certifikatat e Depozitave	-	-
28	Llogari te tjera te klienteve	303,875	306,107
282	Llogari garancie	259,811	261,870
284	Llogari per mbulimin e leterkredive	44,064	44,237
<b>4</b>	<b>MJETE DHE DETYRIME TE TJERA</b>	<b>1,665,996</b>	<b>1,492,352</b>
42	Detyrime te tjera	1,165,297	1,069,813
43	Transaksionet si agjent	-	-
44	Llogari marredheniesh	-	-
45	Llogari pezull dhe te pozicionit	500,699	422,539
<b>5</b>	<b>MJETET E QENDRUESHME DHE BURIMET E PERHERSHME</b>	<b>24,450,090</b>	<b>23,321,023</b>
54	Ndihma dhe financimi publik	-	-
55	Fondet rezerve specifike	1,146,343	1,006,187
56	Boixhi i varur	-	-
<b>57</b>	<b>Kapitali i aksionereve</b>	<b>23,303,746</b>	<b>22,314,836</b>
571	Kapitali i paguar	5,562,518	5,562,518
572	Primet e aksioneve	1,383,880	1,383,880
573	Rezerva	5,177,357	5,177,357
574	Diferenca e rivleresimit	-	-
577	Fitimi (humbja) i pashpemdare	10,191,081	10,092,441
578	Fitimi (humbja) i vitit ushtrimor	988,910	98,640
	<b>TOTALI</b>	<b>196,132,073</b>	<b>192,946,169</b>

Gjatë tremujorit të parë portofoli i depozitave nuk ka pësuar shumë ndryshim në krahasim me tremujorin paraardhës si rezultat i shtimit të llogarive rrjedhëse të klientëve korporatë në monedhën Lek& Usd por edhe ulje të depozitave dhe llogarive rrjedhëse në Eur&Usd të klientëve individë, ndërkohë një impakt të madh pozitivka pasur edhe rritja e kursit të këmbimit.

## 2.2 Pasqyra e të ardhurave

Bazuar në të dhënat e tremujorit të katërt Banka ka patur një fitim të akumuluar prej **988,910 milion Lekë**.

**Pasqyra e te Ardhurave**

LLOGARIA FITIM E HUMBJE	TOTALI	TOTALI
	Mars 2023	Dhjetor 2022
Treguesi (ne mije leke)		
<b>60. SHPENZIME TË VEPRIMTARISË BANKARE</b>	<b>489,250</b>	<b>4,107,712</b>
601. Shpenzime për interesa	225,731	865,092
602. Humbje nga veprimet me letrat me vlerë dhe veprimet financiare	128,321	2,605,711
603. Komisione	120,674	477,857
604. Shpenzime per operacionet e qerase	-	-
605. Shpenzime të tjera të veprimtarisë bankare	14,524	159,052
606. Humbje nga veprimet me valutat	-	-
<b>61. Shpenzime për personelin</b>	<b>385,061</b>	<b>1,479,113</b>
<b>62. Taksa të tjera përveç taksave mbi të ardhurat</b>	<b>32,370</b>	<b>106,087</b>
<b>63. Shpenzime për shërbime të jashtme</b>	<b>404,629</b>	<b>1,657,498</b>
<b>64. Amortizimi dhe fondet rezervë për zhvlerësimin e Mj. të Qëndr.</b>	<b>80,328</b>	<b>390,676</b>
641. Shpenzime amortizimi	80,328	390,676
648. Fonde rezervë	-	-
<b>65. Humbje nga llogaritë për t'u arkëtuar të pambledhshme</b>	<b>187,152</b>	<b>1,083,693</b>
6511. Standarte	28,767	134,092
6512. Në ndjekje	5,746	84,149
6523. Nënstandart	23,021	49,942
6524. Të dyshimta	21,532	41,020
6525. Të humbura	104,749	68,602
<b>66. Shpenzime të jashtëzakonshme</b>	<b>18,101</b>	<b>41,700</b>
<b>67. Taksa mbi të ardhurat</b>	<b>188,975</b>	<b>216,073</b>
<b>69. Fitimi i vitit në vazhdim</b>	<b>988,910</b>	<b>98,640</b>
<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>2,756,677</b>	<b>9,139,491</b>
<b>70. Të ardhura të veprimtarisë bankare</b>	<b>2,034,685</b>	<b>6,791,166</b>
701. Të ardhura nga interesat	852,202	2,272,594
702. Të ardhura nga veprimet me letrat me vlerë &veprimtaritë e tjera financiare	661,127	2,289,683
703. Komisione për shërbime bankare	373,963	1,576,629
704. Të ardhura nga veprimet e qerasë	-	-
705. Të ardhura të tjera të veprimtarisë bankare	3,737	20,431
706. Fitime nga veprimet me valutat	143,656	631,829
<b>74. Transferime nga fondet rezervë për zhvlerësimin e Mj. të Qëndr.</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>75. Transferime nga fondet rezervë për zhvlerësimin</b>	<b>717,950</b>	<b>2,268,711</b>
7511. Standarte	38,059	105,412
7512. Në ndjekje	26,834	67,902
7523. Nënstandart	11,225	37,510
7524. Të dyshimta	38,420	76,664
7525. Të humbura	38,420	76,664
754. Transferime nga fondet rezervë të krijuara për letrat me vlerë	17,893	53,080
757. Të tjera transferime të fondeve rezervë	589,930	1,275,639
<b>76. Të ardhura të jashtëzakonshme</b>	<b>4,042</b>	<b>79,615</b>
<b>79. Humbja e vitit në vazhdim</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>TOTALI I TE ARDHURAVE</b>	<b>2,756,677</b>	<b>9,139,491</b>

Të ardhurat nga interesat në tremujorin e tretë paraqesin një rritje krahasuar me periudhën paraardhese, e shkaktuar kryesisht nga ri-shikimi i normave të interesit për kreditë me interes variabël, rritja e normës së interesit për vendosjet pranë bankave të tjera kryesisht në monedhën Euro dhe rritja e normës së interesit për Bono dhe Thesarit. Të ardhurat nga komisionet, paraqesin një trend më tepër zbritës në krahasim me periudhën paraardhese, ndikuar kryesisht nga zeri 'Karta krediti' dhe "Garanci bankare", megjithë në muajin Mars ka patur një rritje për shkak të produktit "karta krediti me depozitime Cash". Të ardhura nga Trading, paraqet një përmirësim krahasuar me periudhën e kaluar si rezultat i rivlerësimi pozitiv të letrave me vlerë.



### 2.3 Treguesit e rentabilitetit

Më poshtë jepen treguesit kryesor të rentabilitetit të kërkuara në bazë të rregullores nr. 60, “Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja”.

#### Treguesit e perfitueshmerise dhe performances

<b>Nr</b>	<b>Treguesi</b>	<b>Vlera</b>
<b>1</b>	<i>Kthyeshmëria nga aktivet mesatare</i>	<i>0.50</i>
<b>2</b>	<i>Rezultati neto i jashtëzakonshëm/aktivet mesatare</i>	<i>0.01</i>
<b>3</b>	<i>Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë / të ardhurat bruto të veprimtarisë;</i>	<i>41.90</i>
<b>4</b>	<i>Të ardhurat neto nga interesi / shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë;</i>	<i>212.34</i>
<b>5</b>	<i>Kthyeshmëria nga kapitali aksionar mesatar (ROAE) = të ardhurat neto / kapitali aksioner mesatar *100;</i>	<i>4.43</i>
<b>6</b>	<i>Aktive për punonjës = totali i aktiveve / numri I regjistruar i punonjësve;</i>	<i>268,727.26</i>
<b>7</b>	<i>Marzhi neto nga interesat = të ardhurat neto nga interesat / aktive mesatare që sjellin të ardhura;</i>	<i>0.58</i>
<b>8</b>	<i>Të ardhurat neto nga interesat / aktivet mesatare;</i>	<i>0.53</i>
<b>9</b>	<i>Shpenzime për interesa / aktivet mesatare;</i>	<i>0.11</i>
<b>10</b>	<i>Të ardhurat neto nga interesat / të ardhurat bruto të veprimtarisë;</i>	<i>50.04</i>
<b>11</b>	<i>Të ardhurat neto nga veprimtaritë e tjera / aktivet mesatare;</i>	<i>0.26</i>
<b>12</b>	<i>Shpenzimet jo për interesa / të ardhurat bruto të veprimtarisë;</i>	<i>54.60</i>
<b>13</b>	<i>Shpenzime personeli / të ardhurat bruto të veprimtarisë;</i>	<i>18.55</i>
<b>14</b>	<i>Shpenzime për provigjone / aktivet mesatare.</i>	<i>0.27</i>

2.4

## Zërat jashtë bilancit

**Pasqyra e zerave jashte bilancit**

<b>ZERAT JASHTE BILANCIT</b>		
Treguesi (ne mije Lek)	TOTAL	TOTAL
	<b>Mars 2023</b>	<b>Dhjetor 2022</b>
<b>90. ANGAZHIME FINANCIMI</b>	<b>11,547,364</b>	<b>9,479,826</b>
901. Angazhime të dhëna	11,475,007	9,405,319
9011. Institucioneve të kreditit	-	-
9012. Klientëve	11,475,007	9,405,319
902. Angazhime të marra	72,356	74,507
9021. Institucioneve të kreditit	72,356	74,507
9022. Klientëve	-	-
<b>91. GARANCITË</b>	<b>136,744,472</b>	<b>141,437,018</b>
911. Garanci të dhëna	5,815,846	5,797,477
9111. Institucioneve të kreditit	-	-
9112. Klientëve	5,815,846	5,797,477
912. Garanci të marra	130,928,626	135,639,540
9121. Institucioneve të kreditit	5,642,398	5,111,130
9122. Klientëve	125,286,227	130,528,410
<b>92. ANGAZHIME PËR LETRAT ME VLERË</b>	<b>1,716,796</b>	<b>1,116,678</b>
921. Letra me vlerë për t'u dhënë	-	-
922. Letra me vlerë për t'u marrë	1,700,000	1,100,000
923. Letra me vlerë të marra si garanci për kredi ose refinancim	-	-
924. Letra me vlerë të dhëna si garanci për kredi ose refinancim	16,796	16,678
925. Letra me vlerë të marra hua	-	-
926. Letra me vlerë të dhëna hua	-	-
<b>93. TRANSAKSIONE NË VALUTË</b>	<b>3,832</b>	<b>(231)</b>
931. Valutë e blerë me afat	367,979	650,544
932. Valutë e shitur me afat	(967,796)	(653,240)
933. Lek për t'u marrë	648,650	260,889
934. Lek për t'u dhënë	(45,000)	(258,424)
935. Llogari rivlerësimi e operacioneve me afat në valutë	-	-
<b>94. ANGAZHIME TË TJERA</b>	<b>85,973</b>	<b>180,016</b>
941. Angazhime të dyshimta	-	-
942. Të tjera	85,973	180,016
<b>95. ANGAZHIME PËR INSTRUMENTAT FINANCIARË</b>	<b>-</b>	<b>3,595,156</b>
951. Të marra	-	-
952. Të dhëna	-	3,595,156
<b>TOTAL</b>	<b>150,098,437</b>	<b>155,808,463</b>

### 3. Struktura e kapitalit rregullator

Në 31 Mars 2023 struktura e kapitalit rregullator të bankës përbëhet nga:

- Kapitali i paguar (i zotëruar 100% nga Intesa Sanpaolo S.p.a)
- Primet e Aksioneve
- Fitimet e pashpërndara
- Rezervat

Banka nuk ka asnjë instrument e cila është pjese e kapitalit të nivelit të dytë.

<b>Kapitali Rregullator</b>		
<b>Zëri</b>	<b>Shuma</b>	<b>Shuma</b>
	<b>Mars 2023</b>	<b>Dhjetor 2022</b>
<b><u>KAPITALI RREGULLATOR</u></b>	<b>21,486,089.39</b>	<b>21,476,558.21</b>
<b>KAPITAL I NIVELIT TE PARE</b>	<b>21,486,089.39</b>	<b>21,476,558.21</b>
<b>KAPITAL BAZE I NIVELIT TE PARE</b>	<b>21,486,089.39</b>	<b>21,476,558.21</b>
<b>Instrumenta të kapitalit të njohura si Kapital Bazë i Nivelit të Parë (KBN1)</b>	<b>6,946,397.67</b>	<b>6,946,397.67</b>
Kapitali i paguar	5,562,517.67	5,562,517.67
Primet e aksioneve	1,383,880.00	1,383,880.00
<b>Fitimet e pashpërndara</b>	<b>10,092,441.38</b>	<b>10,092,441.38</b>
Fitimet e pashpërndara dhe humbjet e mbartura nga periudhat e mëparshme	10,092,441.38	10,092,441.38
<b>Rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit)</b>	<b>5,177,357.29</b>	<b>5,177,357.29</b>
<b>(-) Aktive të tjera të patrupëzuara</b>	<b>(730,106.95)</b>	<b>(739,638.13)</b>
(-) Shuma bruto e aktiveve të tjera të patrupëzuara	730,106.95	739,638.13
<b>KAPITALI I NIVELIT TE DYTE</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Filtra Prudenciale</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>

Më sipër paraqitet struktura e kapitalit rregullator për fundin e Mars 2023 Që nga Maj 2015 banka ka llogaritur kapitalin rregullator bazuar në rregulloren e re për “Kapitalin Rregullator të bankave”. Deri në implementimin e plotë të standardeve IFRS, banka nuk parashikon impakt material.

#### **4. Mjaftueshmëria e kapitalit**

##### **4.1 Rreziku i kredisë**

Bazuar në rregulloren nr. 48, neni 10, Bankat klasifikojnë çdo ekspozim të zërave, brenda dhe jashtë bilancit, në një nga klasat e ekspozimit në vijim:

- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore;
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale;
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jo tregtare (organizatat joqeveritare/jofitimprurëse);
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit;
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare;
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura;
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave);
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve të klientëve individë (retail);
- ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme;
- ekspozime (kredi) me probleme;
- ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë;
- ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara;
- ekspozime në pozicione të krijuara nga titullzimi (securitization);
- ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SIK; dhe/ose
- zëra të tjerë.

##### **4.2 Rreziku operacional**

Bankat llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun operacional sipas metodës së treguesit të thjeshtë, e cila konsideron të ardhurën neto nga veprimtaria bankare për tre vitet e fundit të veprimtarisë së bankës dhe një koeficient  $\alpha$  prej 15%.

#### 4.3 Totali i zërave të bilancit dhe jashtë bilancit të ndara sipas klasave të ekspozimit.

Zerave te bilancit dhe jashte bilancit te ndara sipas klasave te ekspozimit				
			Mars 2023	Dhjetor 2022
010		<b>KAPITALI RREGULLATOR</b>	<b>21,486,089.39</b>	<b>21,476,558.21</b>
020		<b>RMK (%)</b>	<b>27.87</b>	<b>26.46</b>
030		<b>SHUMA TOTALE E EKSPOZIMEVE TE PONDERUARA ME RREZIK</b>	<b>77,092,875.51</b>	<b>81,156,438.05</b>
		<b>RREZIKU I KREDISE</b>	-	-
040	1.	<b>Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rrezikun e kredisë, kundërpartisë, dhe rrezikun e shlyerjes së transaksioneve jo-DVP - Metoda Standarde (SA)</b>	<b>68,285,587.60</b>	<b>72,349,150.14</b>
050	1.1	Klasat e ekspozimit sipas SA duke përjashtuar pozicionet e titullimit	<b>68,285,587.60</b>	<b>72,349,150.14</b>
060	1.1.1	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore;	2,803,548,683.77	2,845,542,593.08
070	1.1.2	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale;	-	-
080	1.1.3	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jo tregtare (organizatat joqeveritare/jofitimprurëse);	-	-
090	1.1.4	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit;	-	-
100	1.1.5	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare;	-	-
110	1.1.6	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura;	11,129,634.30	13,024,588.05
120	1.1.7	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave);	37,771,744.99	39,998,352.03
130	1.1.8	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail);	10,164,175.31	9,731,485.58
140	1.1.9	Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruar me kolateral pasuri të paluajtshme;	1,212,891.40	1,391,215.28
150	1.1.10	Ekspozime (kredi) me probleme;	677,834.01	626,383.68
160	1.1.11	Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë;	981,121.54	1,133,600.34
170	1.1.12	Ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara;	-	-
180	1.1.13	Ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SIK;	-	-
190	1.1.14	Zëra të tjerë	2,428,925.35	2,443,242.19
200	1.2	Pozicionet e titullimit SA	-	-
200*	1.2*	<i>nga të cilat: rititullime</i>	-	-
		<b>RREZIQET E TREGUT</b>	-	-
210	2.	<b>Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rreziqet e tregut</b>	-	-
220	2.1	<b>Shuma e ekspozimit me rrezik për rrezikun e shlyerjes</b>	-	-
230	2.1.1	Rreziku i shlyerjes në librin e bankës	-	-
240	2.1.2	Rreziku i shlyerjes në librin e tregtueshëm	-	-
250	2.2	<b>Shuma e ekspozimit me rrezik për rrezikun e pozicionit, kursit të këmbimit dhe mallrave (SA)</b>	-	-
260	2.2.1	Rreziku i pozicionit të titujve të borxhit	-	-
270	2.2.2	Rreziku i pozicionit të instrumentave të kapitalit	-	-
280	2.2.3	Rreziku i kursit të këmbimit	-	-
290	2.2.4	Rreziku i investimeve në mallra	-	-
300	2.3	<b>Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun e përgendrimit në librin e tregtueshëm</b>	-	-
		<b>RREZIKU OPERACIONAL</b>	-	-
310	3.	<b>Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun operacional</b>	<b>8,360,677.17</b>	<b>8,360,677.17</b>
320	3.1	<b>Metoda e Treguesit Bazik (BIA)</b>	8,360,677.17	8,360,677.17
330	3.2	<b>Metoda Standarde / Standarde Alternative</b>	-	-

## 5. Informacion i përgjithshëm cilësor për ekspozimin ndaj rreziqeve

Si pasojë e përdorimit të instrumenteve financiare, Banka ekspozohet ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- a) rreziku i kredisë
- b) rreziku i likuiditetit
- c) rreziku i tregut
- d) rreziku operacional

Ky shënim jep informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj secilit prej llojeve të rreziqeve të mësipërm, objektivat e Bankës, politikat dhe proceset për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut si dhe menaxhimin e kapitalit të Bankës.

### 5.1 *Kuadri i Administrimit të Rrezikut*

Këshilli Drejtues i Bankës ka përgjegjësinë kryesore për krijimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të menaxhimit të riskut të Bankës. Këshilli Drejtues ka krijuar Komitetet e Qeverisjes së Bankës (Komiteti i Qeverisjes së Riskut të Kredise, Komiteti i Kredisë, Komiteti i Aseteve të Problemeve, Komiteti i Drejtorëve Ekzekutiv, Komiteti i Rrezikut Financiar, Komiteti i Rrezikut Operacional) të cilat kanë autoritet për vendimmarrje sipas fushave të tyre të caktuara.

Divizioni i Administrimit të Riskut është përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të menaxhimit të riskut të Bankës në këto fusha. Të gjitha komitetet e Bankës kanë anëtarë ekzekutiv dhe jo ekzekutiv dhe raportojnë rregullisht tek Këshilli Drejtues për aktivitetet e tyre.

Politikat e menaxhimit të riskut të Bankës janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar riskun me të cilin përballlet Banka, për të vendosur limitet dhe kontrollin e duhur si dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të riskut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut si dhe produktet dhe shërbimet e ofruara.

## 6. Rreziku i kredisë: Informacion i përgjithshëm

### 6.1 *Rreziku i kredisë*

Në aktivitetin normal të biznesit të saj, Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë në huadhëniet dhe paradhëniet ndaj klientëve dhe institucioneve financiare, investimet në letra me vlerë dhe zëra të tjerë jashtë bilancit. Rreziku i kredisë është risku i një humbjeje financiare të Bankës nëse një klient ose palë e ngjashme që posedon një instrument financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktore që burojnë kryesisht nga huadhëniet e Bankës ndaj klientëve, institucioneve financiare ose që burojnë nga zëra të tjerë jashtë bilancit.

Për arsye raportimi të menaxhimit të riskut Banka konsideron dhe konsolidon të gjithë elementet e ekspozimit të kredisë ndaj riskut (risku individual i mos përmbushjes së detyrimeve, risku i sektorëve të ekonomisë si dhe risku lokal). Banka e menaxhon ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kredisë periodikisht duke monitoruar nga afër limitet e kredisë, portofolin e huave dhe përqendrimin e ekspozimit.

Këshilli Drejtues i Bankës i ka deleguar përgjegjësi për marrjen e vendimeve Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv (DPE), i cili i ka deleguar Komitetit të Kredisë kompetenca për vendimmarrje. Divizioni për Administrimin e Riskut, i cili raporton tek DPE, është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe administrimin e rrezikut të kredisë së Bankës, duke përfshirë detyrat e mëposhtme:

- *Formulimin e politikave të kredisë* duke u konsultuar me njësitë e biznesit, mbulimin e kërkesave për kolateral, vlerësimin e kredisë, përcaktimin e nivelit të riskut dhe raportimin e tij, procedurat e dokumentimit dhe ato ligjore, si dhe përputhshmërinë me kërkesat rregullative dhe statutore.
- *Rishikimin dhe vlerësimin e riskut të kredisë.* Departamenti i Riskut të Kredisë të Bankës vlerëson të gjitha ekspozimet e kredisë përpara angazhimit me klientë nga Banka. Rinovimet dhe rishikimet e kushteve të kredive janë objekt i të njëjtit proces rishikimi.
- *Kufizimi i përqendrimin të ekspozimit ndaj palëve,* sipas shpërndarjes gjeografike dhe industrisë, (për huadhënie dhe paradhënie) si dhe sipas lëshuesit, kategorisë së klasifikimit të kredisë, likuiditetit të tregut dhe vendit (për investimet në letrat me vlerë).
- *Zhvillimi dhe mirëmbajtja e klasifikimit të riskut të Bankës* në mënyrë që të kategorizojë ekspozimet sipas nivelit të riskut të humbjes financiare që përballen si dhe të fokusojë menaxhimin e rreziqeve të tjerë shoqërues. Klasifikimi i riskut përdoret për të përcaktuar nevojën e provigjionimit të nevojshëm të dëmeve ndaj ekspozimeve specifike të kredisë.

Në përputhje me metodologjinë e Bankës të gjitha ekspozimet janë të klasifikuara si ekspozime pa probleme dhe me probleme. Banka klasifikon portofolin e ekspozimeve duke u bazuar në Rregulloren Nr. 62 Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja. Këto rregulla përfshijnë faktet objektive si: shkelja e kontratës, moskryerja e pagesave të interesit dhe principalit; vështirësi të mëdha financiare të huamarrësit; dhe informacione të tjera të rëndësishme financiare për klientin

- *Rishikimi i përputhshmërisë* së njësive të biznesit me limitet e ekspozimit të miratuara duke përfshirë ato për industrinë e zgjedhura dhe llojet e produkteve. Komitetit të Cilësisë së Aktiveve i sigurohen raporte mujore të detajuara mbi cilësinë e kredive të portofoleve lokale ku gjithashtu paraqitet dhe tendenca e tyre dhe veprimet rregulluese të duhura që duhen ndërmarrë.
- *Ofrimi i konsultave, drejtimi dhe aftësi profesionale* ndaj njësive të biznesit për të promovuar në Bankë praktikën më të mirë të menaxhimit të rrezikut të kredisë.

Banka monitoron përqendrimet e riskut të kredisë sipas sektorëve dhe vendit.

Banka përcakton një fond për humbjet nga zhvlerësimi i kredive që përfaqëson një përlogaritje për humbjet në portofolin e kredive.

Provizionet përcaktohen duke përdorur përqindjet e përcaktuara bazuar në Rregulloren Nr. 62 Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja.



Normat e llogaritjes së fondeve rezervë përcaktohen si më poshtë:

- a) për kategorinë “standarde” .....1 (një) për qind;
- b) për kategorinë “në ndjekje” .....5 (pesë) për qind;
- c) për kategorinë “nën-standarde” .....jo më pak se 20 (njëzet) për qind;
- d) për kategorinë “e dyshimtë” ..... jo më pak se 50 (pesëdhjetë) për qind;
- e) për kategorinë “e humbur” ..... 100 (njëqind) për qind

Më poshtë jepet teprica bruto e kredisë sipas maturiteti të mbetur sipas shportave të maturiteteve. Shportat e maturitetit janë në përputhje me formën 37 të SRU.

<b>Teprica Bruto e Kredisë sipas shportave të maturitetit</b>		
	<b>Mars 2023</b>	<b>Shtator 2022</b>
<b>Maturiteti</b>	<b>Totali</b>	<b>Totali</b>
Deri 7 ditë	938,876	3,223,564
7 ditë - 1 muaj	972,763	456,973
1 - 3 muaj	2,156,685	1,805,269
3 - 6 muaj	3,744,748	4,187,481
6 - 12 muaj	10,146,346	10,789,246
1 - 5 vite	19,022,000	20,841,925
> 5 vite	15,970,502	14,827,088
<b>Total</b>	<b>52,951,921</b>	<b>56,131,546</b>

Informacioni i paraqitur më poshtë pasqyron tepricën bruto të kredisë dhënë rezidentëve, ky informacion është paraqitur në linjë me informacionin e raportuar në formularët tre mujore të SRU për shpërndarjen gjeografike.

<b>Klasifikimi i portofolit të kredisë sipas shpërndarjes gjeografike dhe rezidentëve (rretheve)</b>		
<i>ne mijë lek</i>	<b>Mars 2023</b>	<b>Dhjetor 2022</b>
<b>Rrethi</b>	<b>ne mijë lek</b>	<b>ne mijë lek</b>
<i>Tirane</i>	37,670,928	40,966,274
<i>Durres</i>	6,394,351	6,519,793
<i>Elbasan</i>	1,475,255	1,525,538
<i>Shkoder</i>	1,221,482	1,268,045
<i>Korce</i>	519,651	538,984
<i>Vlore</i>	1,107,516	1,038,942
<i>Lushnje</i>	247,749	253,286
<i>Gjirokaster</i>	757,917	577,683
<i>Fier</i>	1,022,874	1,018,733
<i>Berat</i>	534,613	570,272
<i>Lezhe</i>	571,789	482,042
<i>Kavaje</i>	877,219	864,164
<i>Sarande</i>	574,611	538,919
<b>Total</b>	<b>52,975,955</b>	<b>56,162,674</b>

Informacioni i paraqitur më sipër pasqyron tepricën bruto të kredisë dhënë rezidentëve, ky informacion është paraqitur në linjë me informacionin e raportuar në formularin 34 të SRU.

Informacioni i paraqitur më poshtë pasqyron tepricën bruto të kredisë dhe tepricën mesatare gjate 3-mujorit, dhënë subjekteve tregatë rezidente, të ndara sipas llojeve kryesore të ekspozimeve të kredisë. Ky informacion është paraqitur në linjë me informacionin e raportuar në formularin F33B të SRU për shpërndarjen sipas llojeve kryesore të të kredisë.

<b>Teprica bruto e kredisë, teprica mesatare bruto e kredisë gjatë periudhës tremujore, sipas llojeve kryesore të ekspozimeve të kredisë. (000/lekë)</b>		
<i>ne mije lek</i>		
<b>Tipi i klienteve dhe lloji i ekspozimeve</b>	<b>Teprica bruto e kredisë</b>	<b>Teprica mesatare gjate 3-mujorit</b>
<b>Korporata jofinanciare publike</b>	<b>3,447,844</b>	<b>3,490,442</b>
Overdraft	-	0
Kapital qarkullues	3,224,737	3,265,212
Blerje pajisjesh	223,107	225,230
Pasuri të paluajtshme	-	-
Hua të tjera	-	-
<b>Korporata jofinanciare private</b>	<b>32,181,637</b>	<b>33,377,619</b>
Overdraft	1,023,166	1,027,102
Kapital qarkullues	12,309,949	12,897,275
Hua për çelje biznesi	-	-
Blerje pajisjesh	5,458,468	5,396,813
Pasuri të paluajtshme	13,390,055	14,056,429
Hua për investime në instrumenta financiare	-	-
<b>Individë &amp; OJF</b>	<b>17,295,550</b>	<b>17,043,379</b>
Overdraft	728,334	710,283
Mallra jo të qëndrueshëm	212,645	230,219
Mallra të qëndrueshëm	2,393,775	2,220,285
Hua për blerje banesash	13,396,458	13,292,031
Hua për qëllime të tjera	564,338	590,561
<b>Total</b>	<b>52,925,032</b>	<b>53,911,441</b>

Informacioni i paraqitur më poshtë pasqyron tepricën bruto të kredisë dhënë subjekteve tregtare rezidente. Ky informacion është paraqitur në linjë me informacionin e raportuar në formularin F34.2 të SRU për shpërndarjen sipas sektoreve të ekonomisë.

<b>Klasifikimi i portofolit të kredive dhene rezidenteve sipas sektorit të ekonomisë (000/lekë)</b>		
<i>ne mijë lek</i>		
<b>Sektori</b>	<b>Mars 2023</b>	<b>Dhjetor 2022</b>
<i>Bujqësia, Pyjet, Peshkimi</i>	794,427	953,746
<i>Industria nxjerrëse</i>	131,885	100,961
<i>Industria përpunuese</i>	6,513,774	6,598,312
<i>Energjia elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër i kondicionuar</i>	8,370,096	13,887,577
<i>Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve</i>	154,843	60,853
<i>Ndërtimi</i>	2,388,373	2,546,757
<i>Tregtia me shumicë dhe me pakicë; Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave</i>	9,441,101	9,647,023
<i>Transporti dhe magazinimi</i>	803,701	574,936
<i>Akomodimi dhe shërbimi ushqimor</i>	2,520,815	2,299,273
<i>Informacioni dhe komunikacioni</i>	489,387	270,435
<i>Aktivitete financiare dhe të sigurimit</i>	300,564	323,207
<i>Aktivitete të pasurive të paluajtëshme</i>	477,847	549,258
<i>Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike</i>	367,528	421,843
<i>Shërbime administrative dhe mbështetëse</i>	654,089	1,959,730
<i>Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm</i>	14	5
<i>Arsimi</i>	1,693,309	1,838,694
<i>Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale</i>	508,856	455,931
<i>Arte, argëtim dhe çlodhje</i>	9,094	11,347
<i>Aktivitete të tjera shërbimi</i>	9,775	9,763
<i>Aktivitetet të familjeve si punëdhënës; Aktivitete të prodhimit të mallrave e shërbimeve</i>	3	-
<i>Aktivitete të organizatave dhe organizmave ndërkombëtare</i>	-	-
<b>Total</b>	<b>35,629,481</b>	<b>42,509,651</b>

**Fondet per provigjone dhe levizjet gjate periudhes**

Llogarite	Teprica ne	Shtimi i	Rimarrje e	Kredite e	Korigjime te	Teprica ne
	fillim	provigjonv.	provigjonv.	fshira gjate periudhes	tjera gjate periudhes	fund
128 FR per zhvleresimin e bonove te pershtatshme per rfinancim me BQ	89,897	-	(76,963)	-	-	12,935
198 FR per llog per t'u arketuar nga bankat, inst.e kreditit e inst.tjera fin me status te dyshimte	-	3,977,156	(3,977,156)	-	-	-
238 FR per mbulimin e humbjeve nga huate nenstandart	164,734	9,284,216	(9,301,807)	-	-	147,142
248 FR per mbulimin e humbjeve nga huate e dyshimta	56,805	11,631,558	(11,545,049)	-	-	143,314
258 FR per mbulimin e humbjeve nga huate e humbura	374,154	19,615,858	(19,640,938)	12,259	-	361,332
268 FR mbulimin e humbjeve nga llog.per t'u arketuar prej QSH e org tjera publike me status te dyshimte	-	-	-	-	-	-
298 FR per llog per t'u arketuar te klienteve ne status te dyshimte pervec huave	-	-	-	-	-	-
3128 FR per te mbuluar zhvleresimin	1,250,066	-	(525,829)	-	-	724,236
3138 FR per te mbuluar zhvleresimin	-	-	-	-	-	-
3222 FR per te mbuluar zhvleresimin	-	-	-	-	-	-
418 FR per zhvleresimin e mjeteve te tjera	1,165,252	(9,356)	-	-	-	1,155,896
518 FR per zhvleresimin	-	-	-	-	-	-
528 FR per zhvleresimin	-	-	-	-	-	-
538 FR per amortizimin e mj.qendrushme	-	-	-	-	-	-
551 FR per rreziqe e shpenzime	594,273	5,594,528	(5,446,740)	-	-	742,062
558 FR specifike te tjera	411,914	(7,632)	-	-	-	404,281
<b>TOTAL</b>	<b>4,107,095</b>	<b>50,086,328</b>	<b>(50,514,482)</b>	<b>12,259</b>	<b>-</b>	<b>3,691,199</b>

**Fondet Rezerve per mbulimin e humbjeve nga kredite**

Loans classification	Kryegjeja	Fonde rezerve per kryegjene	Interesat e llogaritura	Fonde Rezerve per interesat	TOTALI
	Kredi per klientelen	Kredi per klientelen	Kredi per klientelen	Kredi per klientelen	
Kredi standarte dhe kredi e pakthyer ne afat	50,519,588.54	516,124	181,991	1,794	517,918
Kredi ne ndjekje	949,648	32,597	7,579	230	32,827
Kredi nenstandart	700,309	139,864	7,308	7,278	147,142
Kredi te dyshimta	259,243	129,474	13,860	13,839	143,314
Kredi te humbura	356,844	354,120	7,290	7,212	361,332
<b>Total</b>	<b>52,785,633</b>	<b>1,172,179</b>	<b>218,027</b>	<b>30,354</b>	<b>1,202,533</b>

Në tabelën me sipër paraqiten lëvizjet e provigjoneve si dhe totali i kredive dhe provigjoneve sipas klasifikimit të kërkuar në bazë të rregullores 62 mbi "Rrezikun e Kredisë"

## 6.2 Rreziku i shlyerjes

Aktivitetet e Bankës mund të krijojnë risk në kohën e shlyerjes së transaksioneve dhe tregtimit. Rreziku i shlyerjes është risku i humbjes për shkak të dështimit të një kompanie për të shlyer detyrimet për dhënien e parasë në dorë, letrave me vlerë ose aktiveve të tjera sipas marrëveshjes kontraktuale. Risku i shlyerjes me institucione financiare dhe partnere qeveritar përfshihet brenda një sistemi kufizimesh për të gjitha transaksionet me këta partnere dhe është objekt i monitorimit të përditshëm ashtu siç parashikohet nga dy rregulloret e Bankës së Shqipërisë: "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave" dhe "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit".

## 7. Rreziku i kredisë: Informacion për portofolin e kredisë sipas metodës standard.

Në bazë të shkresës nr. 1997 datë 27/04/2015, Banka e Shqipërisë ka publikuar listën e ECAI të cilat mund të përdoren nga bankat për llogaritjen e ponderimit në bazë të rregullores mbi "Normën e Mjaftueshmërisë së Kapitalit".

Lista e ECAI të cilat mund të përdoren nga Banka:

1. Moody's
2. Fitch
3. Standard and Poor's
4. Japan Credit Rating (JCR)

Banka aktualisht përdor për qëllime të mjaftueshmërisë së kapitalit tre agjencitë e para të vlerësimit.

## 8. Teknikat e zbutjes së rrezikut

Politika e ISBAs për kolateralin është pjesë përbërëse dhe e pandarë e administrimit të rrezikut të kredisë në ISBA dhe dokumenti bazë për zbutjen e riskut të kredisë i cili përcakton rregullat/kushtet e brendshme për pranimin e një grupi standard të llojeve të kolateraleve, duke përfshirë gjithashtu edhe identifikimin e formave të pranueshme të kolateraleve.

Kolaterali/garancia pranohet vetëm për të mbështetur dhe siguruar kredinë dhe nuk shërbejnë për të zëvendësuar aftësinë e kredimarrësit për të përmbushur detyrimet. Për këtë arsye, ato duhet të vlerësohen gjatë procesit të aplikimit për kredi krahas vlerësimit të besueshmërisë dhe kapacitetit të kredimarrësit për ripagimin e kredisë.

Kjo politikë është në përputhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit. ISBA garanton integritetin e administrimit të garancive dhe kolateraleve në funksion të zbutjes së riskut të humbjeve të kredisë.

Grupet kryesore të kolateraleve që pranon ISBA janë si më poshtë:

- Kolateral Cash (mjete monetare)
- Letra me vlerë
- Të ardhura të arkëtueshme
- Pasuri të paluajtshme

- Pasuri të luajtshme
- Garanci
- Nota premtimi
- Letër angazhimi

Rregullat për një grup të pranuar dhe standard të llojeve të kolateralit që përdoren nga Banka për aktivitete kreditimi përshkruajnë dhe përcaktojnë:

- Kushtet për zbatueshmërinë dhe ekzekutimin ligjor,
- Kushtet për procesin e vlerësimit dhe vlerat e pranuar nga Banka në fillim të procesit për lloje të caktuara kolaterali dhe,
- Kushtet për procesin e rivlerësimit

Intesa Sanpaolo Bank Albania, në përputhje me Rregulloren për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit ka në fokus disa objektiva si më poshtë:

- Të inkurajojë dhe garantojë menaxhim dhe administrim optimal;
- Të maksimizojë efektin e zbutjes të kolateralit dhe garancitë për huat në vonesa;
- Të përcaktojë rregullat e përgjithshme për pranimin, vlerësimin, monitorimin dhe administrimin e kolateralit (mbrojtjen me mbulim) dhe garancitë (mbrojtje pa mbulim), si dhe të përcaktojë në mënyrë të detajuar rregullat dhe kërkesat për kolateral/garanci specifike.

Intesa Sanpaolo Bank Albania monitoron kërkesat e pranueshmërisë që duhet të plotësohen në bazë të rregullores së sipërpërmendur për mbrojtjen me mbulim dhe pa mbulim të kredisë. Kërkesat e pranueshmërisë janë referuar në Qasjen e Standardizuar Rregullatore.

Për qëllime të llogaritjes së efekteve të kolateralit financiar është përzgjedhur Metoda e Thjeshtë e Kolateralit Financiar.

Tabela e mëposhtme paraqet vlerën e ekspozimit sipas klasave të kredisë të përcaktuar në rregulloren e mjaftueshmërisë së kapitalit si dhe vlerën e kolateralit të marr në konsideratë për secilën klasë ekspozimi.

Nr.	Klasa e ekspozimit	Vlera Neto	Kolaterali i marre ne konsiderate sipas teknikave te zbutjes te kredise
1	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore;	96,868,403	-
2	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale;	50,415	-
3	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jo tregtare (organizatat joqeveritare/jofitimprurëse);	3,397,595,585	-
4	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit;	2,834,245,544	-
5	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare;	-	-
6	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura;	40,520,896	90,501
7	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave);	47,824,480	574,883
8	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail);	13,382,503	88,736
9	Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruar me kolateral pasuri të paluajtshme;	2,545,113	-
10	Ekspozime (kredi) me probleme;	670,721	-
11	Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë;	680,604	-
12	Ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara;	-	-
13	Ekspozime në pozicione të krijuara nga titullzimi (securitization);	-	-
14	Ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SIK; dhe/ose	-	-
15	Zëra të tjerë.	4,842,793	-

### 9. Rreziku i kredisë së kundërpalës (Institucionet financiare):

Në aktivitetin normal të biznesit të saj, Banka është e ekspozuar ndaj riskut të kredisë në huadhëniet dhe paradhëniet ndaj klientëve dhe institucioneve financiare, investimet në letra me vlerë dhe zërave të tjerë jashtë bilancit. Risku i kredisë është risku i një humbjeje financiare të Bankës nëse një klient ose palë e ngjashme që posedon një instrument financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktore që burojnë kryesisht nga huadhënia e Bankës ndaj klientëve, institucioneve financiare ose që burojnë nga zëra të tjerë jashtë bilancit. Për arsye raportimi të menaxhimit të riskut Banka konsideron dhe konsolidon të gjithë elementet e ekspozimit të kredisë ndaj riskut (risku individual i mos përmbushjes së detyrimeve, risku i sektorëve të ekonomisë si dhe risku lokal).

Banka e menaxhon ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kredisë periodikisht duke monitoruar nga afër limitet e kredisë kundrejt institucioneve të mbikëqyrura, qeverive qendrore ose bankave qendrore si dhe investimeve në instrumentet e kapitalit rregullator në përputhje me rregulloren "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave" e cila i referohet rregullores "Për raportin e mjaftueshmerisë së kapitalit".



## 10. Titullzimi

Jo e aplikueshme (N/A)

## 11. Rreziqet e tregut: Informacion i përgjithshëm

Banka llogarit risk tregu vetëm për pozicionin e hapur valuator. Ne baze të rregullores për mjaftueshmëri të kapitalit banka llogarit kërkesë për kapital në lidhje me riskun e tregut nëse pozicioni valutor është më shumë se 2% e kapitalit rregullator.

## 12. Rreziku operacional

Banka llogarit kërkesën për kapital për rrezikun operacional, sipas metodës së treguesit të thjeshtë, e cila konsideron të ardhurën neto nga veprimtaria bankare për tre vitet e fundit të veprimtarisë së bankës dhe një koeficient  $\alpha$  prej 15%.

Tabela e mëposhtme paraqet totalin e kërkesës për kapital të mbajtur nga banka për rrezikun operacional.

Aktiviteti bankar	Treguesi			Kredi dhe paradhënie (Në rast të aplikimit të metodës standarte të avancuar)			Kërkesa për kapital	Ekspozimet e ponderuara me rrezik
	VITI-3	VITI-2	VITI I FUNDIT	VITI-3	VITI-2	VITI I FUNDIT		
	010	020	030	040	050	060		
010 1. TOTALI I AKTIVITETEVE BANKARE SUBJEKT I METODËS SË TREGUESIT BAZIK (BIA)	4,604,642,518.49	4,893,375,330.83	4,521,410,939.55				700,971,439.44	8,762,142,993.05

## 13. Ekspozimet në instrumente të kapitalit: informacion mbi pozicionet e përfshira në librin e bankës

Jo e aplikueshme (N/A)

## 14. Rreziku i normës së interesit në librin e bankës

Rreziku i normës së interesit ndaj të cilit janë ekspozuar portofolet e Bankës është rreziku i humbjes nga luhatjet e flukseve të ardhshme të parasë ose vlerës së drejtë të instrumenteve financiare për shkak të ndryshimit të normave të interesit të tregut. Ky rrezik krijohet kryesisht nga aktiviteti bankar i lidhur me korporatat dhe individët, si dhe portofoli i letrave me vlerë. Banka përlogarit dhe raporton në baza 3 (tre) mujore rrezikun e normave të interesit, bazuar në udhëzimin "Mbi administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës" date 30.04.2013, nëpërmjet metodës së vlerësimit të ndryshimit në ekspozimin e librit të bankës duke supozuar një goditje (shock) prej +200 pikësh bazë në kurbën referencë të kthimit.

Sipas kësaj metode Banka shpërndan vlerat aktuale të të gjitha pozicioneve të ndjeshme ndaj normës së interesit në 14 intervale kohore. Pozicionet me normë interesi fikse shpërndahen në intervale kohore sipas maturitetit të mbetur, ndërsa ato me normë interesi të ndryshueshme sipas kohës deri në ndryshimin e ardhshëm të normës së interesit. Pozicioni neto për çdo interval kohor shumëzohet me peshat përkatëse, të cilat llogariten si prodhim i goditjes (shock)-ut të normës së interesit +200 pikësh bazë me kohëzgjatjen e modifikuar për çdo interval kohor. Këto përlllogaritje behën për çdo monedhë kryesore mbi baza individuale dhe për monedhat e tjera mbi baza të agreguara. Pozicioni total neto i ponderuar nuk duhet të tejkalojë nivelin prej 20% të kapitalit rregullator të Bankës.

Forma totale e IRRBB-s		Totali i pozicioneve të ponderuara	
IRR		Monedha	Shuma
		1	2
2.	NDRYSHIMI NË VLERËN E EKSPozIMIT		1,860,310,201.45
3.	KAPITALI RREGULLATOR (own funds)		18,532,647,101.68
4.	(NDRYSHIMI NË VLERËN E EKSPozIMIT / KAPITALI RREGULLATOR) * 100		10.04
1.1.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha 1	ALL	- 177,960,037.74
1.2.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha 2	USD	- 102,911,292.35
1.3.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha 3	EUR	- 1,495,478,334.88
1.4.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha 4	GBP	- 83,960,536.49

## 15. Rreziku i likuiditetit

### 15.1 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është përcaktuar si paaftësia e mundshme e një institucioni për të plotësuar detyrimet që ka për pagesa për shkak të paaftësisë për të likuiduar aktive ose për të siguruar financim të mjaftueshëm nga tregu (rreziku i likuiditetit nga financimi), ose për shkak të vështirësive që lidhen me konvertimin e pozicionit të aktiveve financiare që shoqërohen me ndryshime të rëndësishme negative të çmimeve, për shkak të kushteve të papërshtatshme ose çrregullimeve të përkohshme të tregut.

### 15.2 Administrimi i rrezikut të likuiditetit

Metoda e Bankës për menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë sa më shumë të jetë e mundur, që do të ketë gjithmonë likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet e saj kur duhet, në kushte si normale dhe jonormale, pa pësuar humbje të papranueshme ose që rrezikojnë dëmtimin e reputacionit të Bankës. Banka përcakton udhëzimet për administrimin e rrezikut të likuiditetit dhe një plan emergjence të cilat janë objekt i rishikimit nga strukturat e Grupit, dhe aprovimi nga Komiteti i Riskut Financiar të ISBA dhe Këshilli Drejtues. Divizioni i Financës dhe Tregut të Kapitalit është përgjegjës për menaxhimin e likuiditetit dhe Divizioni i Administrimit të Riskut është përgjegjës për monitorimin e treguesve dhe verifikimin e zbatimit të limiteve.

Banka përllongarit dhe siguron në çdo kohë respektimin e treguesit të aktiveve likuide ndaj pasiveve afatshkurtra:

a) në monedhën kombëtare (lekë) dhe në monedhë të huaj në nivelin minimal 15% (pesëmbëdhjetë për qind); dhe

b. në total në nivelin minimal 20% (njëzet për qind).

Tabela më poshtë është forma e kërkuar nga rregullorja nr. 71 “Për Administrimin e Rrezikut të Likuiditetit”

Kodi	AKTIVET LIKUIDE - PASIVET AFATSHKURTRA					TOTALI
	LEKË	USD	EUR	TË TJERA		
	(në mijë lekë)					
1	Arka	845,711	210,791	575,893	32,190	<b>1,664,584</b>
2	Llogaritë me Bankën e Shqipërisë, duke përfshirë rezervën e detyrueshme deri në masen e lejuar të perdomit të saj, të percaktuar me akt nenligjor të Bankes së Shqipërisë	2,369,680	1,082	8,839,034	-	<b>11,209,796</b>
3	Bonot e thesarit të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, të regjistruara në bilanc si “të tregtueshme”/“të vendosjes”	28,633,983	-	-	-	<b>28,633,983</b>
4	80 për qind të obligacioneve të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të regjistruara në bilanc si “të tregtueshme”/“të vendosjes”	18,920,308	-	2,632,363	-	<b>21,552,671</b>
5	Letra me vlerë të investimit të Qeverisë Shqiptare (bono thesari dhe obligacione) me maturim të mbetur deri në 1 (një) muaj	-	-	-	-	-
6	80 për qind të letrave me vlerë të qeverisë shqiptare (bono thesari dhe obligacione), që nuk bëjnë pjesë në kodin “3”, “4” dhe “5”, por që plotësojnë kriteret e rregulloreve të Bankës së Shqipërisë “Mbi garancitë në operacionet kredituese të Bankës së Shqipërisë” dhe “Mbi marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes”	6,108,414	-	-	-	<b>6,108,414</b>
7	Bonot e thesarit të blera sipas marrëveshjeve të riblerjes, kur maturimi i mbetur i marrëveshjes së riblerjes është deri në 7 (shtatë) ditë	-	-	-	-	-
8	Llogaritë rrjedhëse në bankat dhe institucionet e tjera financiare	-	3,738,418	2,680,681	832,369	<b>7,251,468</b>
9	Depozita me bankat dhe institucionet e tjera financiare me maturim të mbetur deri në 7 (shtatë) ditë	2,000,000	-	679,260	167,193	<b>2,846,453</b>
10	Hua për bankat dhe institucionet e tjera financiare me maturim të mbetur deri në shtatë ditë (përfshihet llogaria 157 “hua të pakthyera në afat ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare”);	-	-	-	-	-
11	Letrat me vlerë të tregtueshme/“të vendosjes” të emetuara nga qeveritë qendrore dhe bankat qendrore me klasifikime nga agjencitë ndërkombëtare të rating-ut ekuivalente me klasifikimin e S&P jo më pak se A +;	-	-	903,914	-	<b>903,914</b>
12	Letra me vlerë të tregtueshme/“të vendosjes” të emetuara nga institucione financiare me vlerësim nga agjencitë ndërkombëtare të rating-ut ekuivalente me klasifikimin e S&P jo më pak se A+;	-	-	-	-	-
13	Letra me vlerë të tregtueshme/“të vendosjes” që nuk janë të vlerësuar, por të emetuara nga banka ndërkombëtare të zhvillimit të listuara në rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave”;	-	516,109	2,265,728	-	<b>2,781,838</b>
14	Letra me vlerë të investimit me maturim të mbetur deri në 1 (një) muaj (duke përfshirë letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare të përfshira në shkronjat e mësipërme)	-	-	-	-	-
15	Letra me vlerë të blera sipas marrëveshjes së riblerjes, kur maturimi i mbetur i marrëveshjes së riblerjes është deri në 7 (shtatë) ditë	-	-	-	-	-
<b>A</b>	<b>TOTALI I AKTIVEVE LIKUIDE</b>	<b>58,878,096</b>	<b>4,466,399</b>	<b>18,576,873</b>	<b>1,031,752</b>	<b>82,953,121</b>
<b>B</b>	<b>TOTALI I PASIVEVE AFATSHKURTRA ME AFAT TË MBETUR MATURIMI DERI NË 1 VIT</b>	<b>54,385,626</b>	<b>10,609,783</b>	<b>88,337,678</b>	<b>2,505,787</b>	<b>155,838,875</b>
<b>C</b>	<b>TREGUESI I LIKUJDETITIT (në %)</b>					
1	Aktive likuide / pasive afatshkurtra * 100 (per monedhen kombetare LEK)					<b>108.26%</b>
2	Aktive likuide / pasive afatshkurtra * 100 (per monedhat e huaja)					<b>23.73%</b>
3	Aktive likuide / pasive afatshkurtra * 100 (ne total)					<b>53.23%</b>

## 16. Depozita ekuivalente e kapitalit të degës së bankës së huaj

Jo e aplikueshme (N/A)

## 17. Matja dhe kontrolli i kufijve të rrezikut të degës së bankës së huaj

Jo e aplikueshme (N/A)

## 18. Politikat e shpërblimit

Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. aplikon politikat e shpërblimit, duke patur parasysh treguesit cilësor dhe sasior, në përputhje me politikën e përgjithshme të Intesa Sanpaolo s.p.a. duke u bazuar gjithashtu edhe tek rregulloret dhe politikat lokale.

Raporti ku përshkruhen në mënyrë të detajuar këto politika të Grupit Intesa Sanpaolo, gjenden duke ndjekur linkun: (si PDF në fund të faqes)

<https://www.intesasanpaolobank.al/retail/footer/struktura-organizative.html>

### 19. Format dhe elementet e shpërblimit për Këshillin Drejtues dhe Drejtuesit Ekzekutivë

Shpërblimi Këshillit Drejtues është i përbërë vetem nga komponente fikse që i përket detyrave të kryera nga ata në cilësinë e anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Shpërblimi i Drejtuesve Ekzekutiv është i përbërë nga komponenti i fikse dhe komponenti i variabël si mëposhtë vijon (<https://www.intesasanpaolobank.al/retail/footer/struktura-organizative.html>)

	2021 Value /000Lek
<b><u>Tabelë 19: Format dhe elementët e shpërblimit për Drejtuesit ekzekutivë (çdo fund viti )</u></b>	
<b>Vlera totale e agreguar e pagesave dhe shpërblimeve për vitin aktual fiskal [2021] e menjehershme/per periudhen aktuale. Per periudha te kaluara</b>	
<b>Drejtuesit Ekzekutive</b>	
<i>Elementë të pandryshueshëm të shpërblimit</i>	120,877.56
Cash/bonus	
aksione	15,198.66
të tjera	36,190.49
<i>Elementë të ndryshueshëm të shpërblimit</i>	
Cash/bonus	22,064.80
aksione	
të tjera	

	Value /000Lek
<b><u>Tabelë 19: Format dhe elementët e shpërblimit për Këshillin Drejtues dhe Komitetin e Kontrollit (çdo fund viti )</u></b>	
<b>Vlera totale e agreguar e pagesave dhe shpërblimeve për vitin aktual fiskal [2021] e menjehershme/per periudhen aktuale. Per periudha te kaluara</b>	
<b>Keshilli Drejtues dhe Komitetin e Kontrollit</b>	
<i>Elementë të pandryshueshëm të shpërblimit</i>	6,518.34
Cash/bonus	
aksione	
të tjera	
<i>Elementë të ndryshueshëm të shpërblimit</i>	
Cash/bonus	
aksione	
të tjera	

### 20. Politikat kontabël

Politikat kontabël të përcaktuara me poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme për të gjithë periudhën e pasqyrave të konsoliduara financiare nga njësitë e Bankës.

**(a) Monedha e huaj**

Transaksionet në monedhe të huaj janë konvertuar fillimisht në monedhën funksionale të Bankës me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në valutë të huaj janë rikonvertuar në monedhën funksionale me kurset e këmbimit në datën e mbylljes së bilancit. Të gjitha diferencat respektive njihen në pasqyrën e të ardhurave.

Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare në valutë të huaj të matura me vlerën e drejtë, janë rikonvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së përcaktimit të vlerës së drejtë. Diferencat e konvertimit të cilat rezultojnë nga rikonvertimet njihen në pasqyrën e të ardhurave.

**(b) Mjete monetare dhe të ngjashme**

Mjete monetare dhe të ngjashme përfshijnë mjetet në arkë, gjendjet e pakufizuara me bankat qendrore dhe depozitat afat shkurtra shume likuide me maturitet me pak se tre muaj, të cilat janë subjekt i ndryshimeve jo të rëndësishme të vlerës së tyre të drejtë dhe përdoren nga Banka për përmbushjen e angazhimeve të saj afatshkurtra. Mjete monetare dhe të ngjashme mbahen në bilanc me koston e amortizuar.

**(c) Investime në letra me vlerë**

Të gjitha investimet në letra me vlere njihen fillimisht me koston, e cila është vlere e drejtë e caktuar plus kostot e investimit për blerje. Pas njohjes fillestare çdo letër me vlerë e investimit e cila mbahet nga Banka klasifikohet në portofole në përputhje me qëllimet e Bankës për blerjen e letrave me vlere në vijim të strategjive për investime në letra me vlere. Ato klasifikohen si më poshtë:

**(i) Letra me vlerë të investimit**

Letrat me vlerë të investimit janë aktive financiare jo derivative me të ardhura fikse ose të përcaktueshme dhe me maturitete fikse për të cilat Banka ka qëllimin pozitiv dhe aftësinë t'i mbajë deri në maturim dhe që nuk klasifikohen si të tregtueshme ose letra me vlerë të vendosjes. Letrat me vlerë të investimit mbarten me koston e amortizuar nëpërmjet metodës së interesit efektiv duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi

**(ii) Letra me vlerë të vendosjes**

Letrat me vlerë të vendosjes janë letrat me vlerë të cilat Banka i blen për ti mbajtur për një periudhë më shumë se gjashtë muaj, me përjashtim të atyre letrave me vlerë, të cilat banka synon ti mbajë deri në maturim dhe të cilat përmbushin rregullat për letrat me vlerë të investimit. Letrat me vlerë të vendosjes përfshijnë gjithashtu letrat me vlere të cilat nuk mund të njihen as si letra me vlere të tregtueshme dhe as si letra me vlere të investimit.

Letrat me vlere të vendosjes njihen fillimisht me çmimin e blerjes pa përfshirë kostot e blerjes. Në çdo datë bilanci, provizionet përlogariten për humbjet e përealizuara të kapitalit të cilat rezultojnë

nga diferenca midis vlerës kontabël dhe çmimit të tregut të letrave me vlerë. Fitimet e përealizuara të kapitalit nuk njihen në pasqyrën e të ardhurave, siç përshkruhen në shënimin 4 (m).

**(d) Huat dhe paradhëniet për bankat dhe klientët**

Huat dhe paradhëniet për bankat dhe klientët janë aktive financiare jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme të cilat nuk janë të kuotuar në një treg aktiv dhe Banka nuk ka për qëllim shitjen e tyre të menjëhershme ose në një kohë të afërt.

Huat dhe paradhëniet për klientët njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe për rrjedhojë mbahen me vlerën e tyre të kostos, duke zbritur të gjitha vlerat e përlogaritura të humbjeve të mundshme nga kreditë. Huat fshihen nga bilanci me vendim të Këshillit Drejtues të Bankës, nëse klienti nuk paguan dhe është në vështirësi serioze për të paguar ose kur të ardhurat nga kolaterali nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar të gjithë ekspozimin. Huat kontabilizohen në momentin e disbursimit dhe pagesa e kredive kontabilizohet në momentin e arkëtimit. Interesi njihet në bazë të metodës së interesit efektiv.

**(e) Provizione për humbjet nga huatë**

Politikat për provigjionimin e huave janë në përputhje me kuadrin rregullator të Bankës së Shqipërisë “Për Administrimin e Rrezikut të Kredisë”. Në bazë të kërkesave përkatëse mbikëqyrëse, Banka klasifikon huat e akorduara në pesë kategori të riskut. Për çdo kategori të riskut aplikohen normat e provizionit për humbjet e mundshme të huave vijon si më poshtë:

<i>Klasifikimi</i>	<i>Normat e fondit rezervë mbi principalin</i>	<i>Normat e fondit rezervë mbi interesin</i>
Standard	1%	1%
Në ndjekje	5%	5%
Nën standard	20%	100%
Të dyshimta	50%	100%
Të humbura	100%	100%

Strukturat përkatëse organizative të Bankës vendosin për klasifikimin e portofolit të kredisë në një nga kategoritë e sipër përmendura në bazë të një analize, e cila merr në konsideratë tiparet parësore dhe shtesë të renditura më poshtë:

- a) situatën financiare të huamarrësit;
- b) situatën financiare të garantorit;
- c) cilësinë e kolateralit të siguruar;
- d) ditët e vonesës;
- e) lëvizjet në llogarinë e overdraftit të huamarrësit;

f) restrukturimi i huas si rezultat i përkeqësimit të situatës financiare të huamarrësit.

**(f) Marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjes**

Letrat me vlerë të blera sipas marrëveshjeve për t'u rishitur (marrëveshjet e anasjellta të riblerjeve) dhe letra me vlerë të shitura sipas marrëveshjeve për të ri-blerë (marrëveshjet për riblerje), në përgjithësi trajtohen si transaksione financiare të garantuara dhe kryen në formën e parapagimeve ose arkëtimeve plus interesin e përlllogaritur. Letrat me vlere të marra mbi bazën e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes dhe letrat me vlerë të dhëna sipas marrëveshjeve të riblerjes nuk njihen ose hiqen nga bilanci, derisa hiqet dore nga kontrolli i të drejtave kontraktuale të cilat përfshijnë këto letra me vlerë. Interesat e fituara nga marrëveshjet e anasjellta të riblerjeve dhe interesi i marrëveshjeve të riblerjeve njihen si teëardhura nga interesat ose shpenzime interesi për secilën marrëveshje, mbi jetën e çdo marrëveshje. Të gjitha marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellta janë kryer me Bankën Qendrore të Shqipërisë.

*Sigurimi me mjete monetare i marrëveshjeve të riblerjes së anasjelltë/marrëveshjet e riblerjes.*

Transaksionet e huadhënies dhe huamarrjes se letrave me vlere ne përgjithësi janë të siguruara me letra me vlere ose mjete monetare. Transferimi i letrave me vlere kundrejt palëve pasqyrohet në pasqyrën e bilancit të konsoliduar vetëm nëse transferohen edhe rreziqet dhe përfitimet e pronësisë. Pagesa ose arkëtimi paraprak si kolateral regjistrohet si aktiv ose pasiv. Informacion më i detajuar pasqyrohet në shënimin13.

**(g) Ndërtesat dhe pajisjet**

(i) Njohja dhe matja . Ndërtesat dhe pajisjet paraqiten me koston e tyre neto pasi iu është zbritur zhvlerësimi i akumuluar dhe ndonjë humbje nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë të gjitha shpenzimet të cilat mund t'i atribuohen në mënyre të drejtpërdrejtë blerjes së mjetit. Nëse pjesë të një aktivi kanë jetëgjatësi përdorimi të ndryshme, atëherë këto pjesë kontabilizohen si elemente të veçanta (përbërësit kryesor) të ndërtesave dhe pajisjeve. Të gjitha fitimet ose humbjet nga shitja e një ndërtesë dhe pajisje (të llogaritur si diferenca midis të ardhurave neto nga shitje dhe vlere e mbartur e objektit) njihet me të ardhurat e tjera në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Kosto të tjera rrjedhëse. Kostot e zëvendësimit të një pjese të një ndërtesë ose pajisjeje njihen me vlerën e mbartur të aktivit nëse është e mundur që të sigurohen përfitime të ardhshme ekonomike dhe nëse kostot e tij mund të maten në mënyrë të besueshme.

(iii) Zhvlerësimi njihet ne pasqyrën e të ardhurave duke përdorur metodën lineare përgjatë kohëzgjatjes se jetës se dobishme te çdo pjese te ndërtesës dhe pajisjes. Trualli dhe Veprat e Artit nuk zhvlerësohen. Ndryshimet ne jetëgjatësinë e pritshme te përdorimit kontabilizohen duke ngarkuar periudhën ose metodën e amortizimit ne varësi të rastit, dhe trajtohen si ndryshime në përlllogaritjet (parashikimet) kontabël. Jetëgjatësie e parashikuara të përdorimit për periudhën aktuale dhe periudhën krahasuese janë të paraqitura si më poshtë:

- Ndërtesat 20 vjet



- Mobiliet, orenditë dhe pajisjet 5 vjet
- Automjetet 5 vjet
- Kompjuterët dhe pajisje të tjera kompjuterike 4 vjet
- ATM-te 8 vjet
- POS-et 7 vjet

#### **(h) Aktive Afatgjata Jomateriale**

Programet kompjuterike, licencat dhe markat tregtare përbëjnë aktivet afatgjata jomateriale të cilat paraqiten me koston neto pas zbritjes të amortizimi të akumuluar.

Shpenzimet e mëtejshme në aktivet afatgjata jomateriale kapitalizohen vetëm nëse këto shpenzime rrisin të mirat e ardhshme ekonomike të këtij mjeti specifik. Çdo lloj kostoje tjetër shpenzohet në periudhën në të cilën kryhet. Amortizimi pasqyrohet te pasqyra e të ardhurave duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit për jetëgjatësinë e një programi duke filluar nga data e përdorimit të tyre. Amortizimi për licencat dhe markat tregtare paraqiten në pasqyrën e të ardhura në mënyrë lineare e cila aplikohet për jetëgjatësinë për një periudhë të caktuar.

Jetëgjatësitë e parashikuara të përdorimit për periudhën aktuale dhe periudhën krahasuese janë të paraqitura si më poshtë:

- Programet kompjuterike 4 vjet
- Licencat dhe markat tregtare 10 vjet

#### **(i) Depozitat dhe borxhi i varur**

Kur Banka shet një aktiv financiar dhe në të njëjtën kohë nënshkruan një marrëveshje për riblerjen e aktivit (ose të një aktivi të ngjashëm) me çmim fiks në një datë të më vonë (“repo” ose “stock lending”) marrëveshja kontabilizohet si depozitë, dhe aktivi në fjalë vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës. Depozitat dhe borxhet e varura fillimisht maten me vlerën e drejte plus kostot direkte të transaksionit, dhe me pas maten me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit, përveçse nëse Banka vendos të mbarte detyrime me vlerën e drejtë nëpërmjet njohjes në pasqyrën e të ardhurave

#### **(j) Provizione për rreziqe dhe shpenzime**

Një provizion për rreziqet dhe shpenzimet (ndryshe nga humbjet e kredisë) njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje në të kaluarën Banka disponon një detyrim ligjor ose konstruktiv që mund të vlerësohet me besueshmëri dhe që gjithashtu është e mundur që të kërkojë dalje të përfitimeve ekonomike për të mbyllur detyrimin.

#### **(k) Interesat**

Interesat llogariten në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe në bazë të kushteve kontraktore të nënshkruara midis Bankës dhe palëve të treta. Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi

kontabilizohen me parimin e përlogaritjes. Interesi i llogaritur paraqitet së bashku me zërin përkatës të bilancit.

#### **(l) Tarifat dhe komisionet**

Tarifat dhe komisionet për transaksione të ndryshme operationale amortizohen gjatë gjithë jetëgjatësisë së aktivitetit dhe pasivitetit financiar në fjale për të cilin realizohet ose shpenzohet. Të ardhura të tjera nga tarifat dhe komisionet, duke përfshirë tarifat e shërbimit, tarifat për menaxhimin e investimeve, komisioni i shitjeve dhe tarifat e depozitave njihen në momentin e kryerjes së shërbimit përkatës.

Shpenzime të tjera për tarifat dhe komisionet lidhen kryesisht me tarifat për transaksionet dhe shërbimet, të cilat shpenzohen në momentin e marrjes së shërbimit.

#### **(m) Të ardhura nga këmbimet valutore dhe aktivitete të tjera bankare**

Këto të ardhura përfshijnë fitimet neto nga veprimet e këmbimeve valutore dhe rezultatin financiar neto nga rivlerësimi i mjeteve dhe detyrimeve. Kthimi i një zëri të fshire nga bilanci, që aplikohet për huatë e humbura të Bankës, regjistrohen në zërin të ardhura nga huatë e humbura, të cilat raportohen në këtë kategori.

#### **(n) Shpenzimet e punonjësve**

##### **(i) Planet e përcaktuara të kontributeve**

Banka operon vetëm me kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore që sigurojnë përfitime pensioni për personelin në momentin e daljes në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjës për të siguruar minimumin e nivelit të pensionit sipas ligjit për pensionet në Shqipëri sipas një plani të përcaktuar kontributi për pensionin. Kontributet e Bankës ndaj përfitimeve të planit të pensionit pasqyrohen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

##### **(ii) Përfitimet afatshkurtra**

Detyrimet për përfitimet afatshkurtër të punonjësve llogariten mbi një bazë të paskontueshme dhe njihen si shpenzime kur shërbimi përkatës është siguruar. Një provizion njihet për vlerën e pritur për t'u paguar nëqoftëse Banka ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i një shërbimi të kryer në të kaluarën nga punonjësi dhe ky detyrim mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

#### **(o) Qiraja dhe përmirësimet e qirasë**

Përcaktimi nëse një marrëveshje është qira ose përmban një qira, bazohet në thelbin e marrëveshjes dhe kërkon një vlerësim nëse përmbushja e marrëveshjes varet nga përdorimi i një aktivi ose aktiveve të caktuara dhe marrëveshja njihet të drejtën për të përdorur aktivin.

Banka ka vetëm marrëveshje qereje operative, pagesat e të cilave njihen në pasqyrën e të ardhurave në mënyrë lineare gjatë kohëzgjatjes së qirasë. Kostot e ristrukturimit të kryera në këto ambiente që

përdoren në bazë të këtyre marrëveshjeve kontabilizohen si aktivet e tjera dhe amortizohen gjatë kohëzgjatjes së qirasë në mënyrë lineare. Pagesat e qirasë së rastit kontabilizohen duke rishikuar pagesat minimale të qerases gjatë periudhës së mbetur të qirasë në momentin e konfirmimit të rregullimit të qerasë.

**(p) Tatimi mbi fitimin**

Banka përcakton tatimin në fund të periudhës në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar. Tatimi mbi fitimin që paguhet llogaritet sipas rregullimit të rezultatit financiar statutor me zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të parashikuara në legjislacionin Shqiptar.

**(r) Transaksionet jashtë bilancit**

Transaksionet jashtë bilancit përfaqësojnë marrëveshjet midis bankave dhe palëve të tjera. Këto marrëveshje përfaqësojnë të drejtat dhe angazhimet të cilat ka mundësi të sjellin një aktiv ose pasiv në zbatim të kushteve kontraktuale. Njohja ndodh në momentin e nënshkrimit të kontratës. Angazhimet mbartin një rrezik të mundshëm të kredisë e cila shpërblehet me një komision. Për angazhime të caktuara, një provizion krijohet për të mbuluar rrezikun e mundshëm të kredisë. Mosnjohja ndodh nëse aktivi ose pasivi respektiv realizohet në datën e mbarimit/maturimit të kontratës.